

Haxhi ADEMI

Instituti i Historisë “Ali Hadri”

Email: ademihaxhi@hotmail.com

ORCID: 0009-0003-0165-6247

KUD: 94(496.51)(797.11)“1945”(05)

**PROCESI I ANEKSIMIT TË KOSOVËS NGA SERBIA
NË VITIN 1945: KONTEKSTI HISTORIK, POLITIK
DHE JURIDIK****Abstrakt:**

Ky studim trajton në mënyrë të gjithanshme procesin e aneksimit të Kosovës nga Serbia, i cili u konkretizua përmes Mbledhjes së Dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Kosovës dhe Metohisë, të njohur si Kuvendi i Prizrenit (8–10 korrik 1945). Ky kuvend, i organizuar në një klimë të tensionuar politike dhe nën kontroll të drejtpërdrejtë të administratës ushtarake jugosllave, përfaqëson një nga momentet më përcaktuese në historinë politike të Kosovës gjatë shekullit XX. Delegatët e përzgjedhur sipas kriterëve strikte politike, prania e forcave të armatosura dhe mungesa e garancive demokratike e bënë të pamundur shprehjen e lirë të vullnetit popullor. Në këto rrethana u miratua një rezolutë e përgatitur paraprakisht në Beograd, e cila sanksiononte bashkimin e Kosovës me Republikën Popullore të Serbisë, duke anashkaluar tërësisht të drejtën e shqiptarëve për vetëvendosje. Ky akt ishte në kundërshtim të hapur me Rezolutën e Konferencës së Bujanit e cila njihte qartë të drejtën e popullit shqiptar të Kosovës për bashkim me Shqipërinë pas luftës. Në Kuvendin e Prizrenit u krijua “Gjyqi Popullor i Krahinës”, një organ represiv i cili synonte ndëshkimin e kundërshtarëve politikë dhe të aktivistëve të Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare. Ky gjyq shqiptoi dënime të rënda politike, duke goditur çdo formë rezistence ndaj pushtetit të ri jugosllav. Ligjet e miratuara në gusht dhe shtator të vitit 1945 e institucionalizuan aneksimin, duke e përcaktuar Kosovën si “Qark Autonom i Kosovës dhe Metohisë” brenda Serbisë, me kompetenca të kufizuara, me mungesë të theksuar autonomie reale dhe me humbje të mëtejshme territoriale në disa zona me shumicë shqiptare. Studimi është ndërtuar jo vetëm në zhvillimet e vitit 1945, por duke e vendosur procesin

e aneksimit në një vijimësi historike më të gjatë. Në këtë kuadër, punimi nis me periudhën e pushtimit dhe aneksimit të Kosovës nga Serbia që prej tetorit 1912, kur Kosova dhe trevat shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi u pushtuan nga ushtritë serbo-malazeze. Vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër vulosën copëtimin e hapësirës shqiptare, duke e lënë Kosovën, viset shqiptare jashtë kufijve të shtetit shqiptar. Kjo periudhë u karakterizua nga dhunë e sistematizuar, shpërngulje masive dhe politika represive që synonin ndryshimin etnik të territoreve shqiptare. Studimi analizon gjithashtu pozitën juridike dhe administrative të Kosovës gjatë Luftës së Parë Botërore, ndarjen e saj në banovina gjatë periudhës mes dy luftërave botërore, si dhe ndarjen e Kosovës në tri zona pushtuese gjatë Luftës së Dytë Botërore. Qëllimi është të paraqitet në mënyrë objektive dhe të paanshme konteksti historik që e bëri të mundur aneksimin e vitit 1945, duke e parë atë si vijimësi të një politike të ndërtuar mbi mohimin e të drejtave të shqiptarëve. Risia e këtij studimi qëndron në qasjen ndërdisiplinore dhe në analizën e bazës historike, politike dhe juridike të aneksimit, duke shqyrtuar njëkohësisht përpjekjet shqiptare për kundërshtimin e ripushtimit jugosllav, diskursin politik serb mbi Kosovën dhe pasojat afatgjata për popullsinë shqiptare. Punimi mbështetet në burime arkivore, literaturë vendore dhe ndërkombëtare, si dhe shtypin ditor të kohës, në përputhje me metodat analitike, krahasuese dhe qasjen kronologjike të historiografisë bashkëkohore.

Fjalë kyçe: Kosova, aneksim, Serbia, Kuvendi i Prizrenit, vetëvendosje.

Abstract:

This study comprehensively addresses the process of Kosovo's annexation by Serbia, which was concretized through the Second Assembly of the Anti-Fascist National Liberation Council of Kosovo and Metohija, known as the Assembly of Prizren (8–10 July 1945). This assembly, organized in a politically tense climate and under the direct control of the Yugoslav military administration, represents one of the most decisive moments in Kosovo's political history during the 20th century. Delegates selected according to strict political criteria, the presence of armed forces, and the absence of democratic guarantees made the free expression of popular will impossible. Under these circumstances, a resolution prepared in advance in Belgrade was adopted, sanctioning the union of Kosovo with the People's Republic of Serbia, completely bypassing the

right of the Albanians to self-determination. This act was in open contradiction with the Bujan Conference Resolution, which clearly recognized the right of the Albanian people of Kosovo to unite with Albania after the war. At the Assembly of Prizren, the "People's Court of the Province" was established, a repressive body aimed at punishing political opponents and activists of the Albanian National Democratic Movement. This court imposed severe political penalties, targeting any form of resistance to the new Yugoslav authority. The laws passed in August and September 1945 institutionalized the annexation, designating Kosovo as the "Autonomous District of Kosovo and Metohija" within Serbia, with limited powers, a marked lack of real autonomy, and further territorial losses in several areas with an Albanian majority. The study is built not only on the developments of 1945 but also by placing the annexation process within a longer historical continuity. In this context, the paper begins with the period of Kosovo's occupation and annexation by Serbia from October 1912, when Kosovo and the Albanian-inhabited territories in Macedonia and Montenegro were occupied by Serbian - Montenegrin armies. The decisions of the London Conference of Ambassadors sealed the partition of Albanian lands, leaving Kosovo and other Albanian areas outside the borders of the Albanian state. This period was characterized by systematic violence, mass displacement, and repressive policies aimed at altering the ethnic composition of Albanian territories. The study also analyzes the legal and administrative status of Kosovo during the First World War, its division into banovinas during the interwar period, as well as the partition of Kosovo into three occupation zones during the Second World War. The aim is to present the historical context that made the 1945 annexation possible in an objective and impartial manner, viewing it as a continuation of a policy built on the denial of the rights of the Albanians. The novelty of this study lies in its interdisciplinary approach and in the analysis of the historical, political, and legal basis of the annexation, while simultaneously examining Albanian efforts to resist the Yugoslav reoccupation, the Serbian political discourse on Kosovo, and the long-term consequences for the Albanian population. The paper relies on archival sources, local and international literature, as well as contemporary daily press, in accordance with the analytical, comparative, and chronological approaches of contemporary historiography.

Keywords: Kosovo, annexation, Serbia, Assembly of Prizren, self-determination.

Hyrje

Në tetor të vitit 1912, Kosova dhe trevat shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi u pushtuan nga ushtritë serbo-malazeze. Po gjatë Luftërave Ballkanike, trevat shqiptare në jug u pushtuan nga ushtria greke, ndërsa një pjesë e territoreve shqiptare mbetën nën administrim të përkohshëm shqiptar vetëm pas shpalljes së pavarësisë. Një vit më pas, në vitin 1913, vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër vulosën copëtimin e hapësirës shqiptare, duke i lënë jashtë kufijve të shtetit të ri jo vetëm Kosovën e viset shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi, por edhe Çamërinë dhe territore të tjera të pushtuara nga Greqia, të cilat iu bashkëngjitën strukturave shtetërore sllave dhe greke të Ballkani.¹ Pushtimi u shoqërua me dhunë të sistematizuar, masakra dhe shpërngulje masive, të cilat ishin pjesë e politikës shtypëse të shteteve fqinje të Shqipërisë.²

Mirëpo, aneksimi i këtyre territoreve më 1912-13 nuk ishte ligjor për së paku dy arsye: Së pari, për shkak se nuk është mbajtur asnjë kuvend i madh kombëtar serb, siç e parashihte Kushtetuta e vitit 1903, në të cilin do të diskutohej dhe do të ratifikohej zgjerimi i kufijve të Serbisë dhe përfshirja e Kosovës dhe e Maqedonisë. Së dyti, për shkak se kur një territor kalon nga një shtet në një shtet tjetër nëpërmjet pushtimit në kohë lufte, kalimi duhet të njihet nëpërmjet një traktati të lidhur ndërmjet dy palëve ndërluftuese, pas luftës. Ndonëse Traktati i Londrës (1913), u lidh ndërmjet aleatëve ballkanas, ku përfshihet edhe Serbia dhe shteti osman nga fundi i luftës, ky traktat kurrë nuk u ratifikua nga Serbia, prandaj nuk ka vlerë ligjore për sa u përket territoreve të reja të saj. Po ashtu, vlerë ligjore nuk kishin as traktatet e mëvonshme që lidhën Serbia dhe Turqia, si Traktati i Bukureshtit (1913), Traktati i Stambollit (1914), Traktati i Sevrës (1920) dhe Traktati i Ankarasë (1925), ngase ose nuk u ratifikuan ose nuk përmenden në mënyrë specifike territetet që i kishin marrë njëra-tjetrës në vitet 1912-1913.³

¹ *Historia e Popullit Shqiptar*; Vëllimi III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë & Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, 18-29; Miranda Vickers, *Shqiptarët, një histori moderne*, Tiranë: “Bota Shqiptare”, 2008, 115-118; Arben Puto, *Shqipëria politike (1912-1939)*, Tiranë: “Toena”, 2009, 53-95.

² Marenglen Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, 1992), 9.; Raymond Poincaré, *Lufta e parë dhe e dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Londrës (1912-1913)*, Shkup: Logo-A, 2005, 17.

³ Noel Malcolm, *Kosova, një histori e shkurtër*; Prishtinë: Koha, 2011, 342-343.

Gjendja e shqiptarëve u rëndua edhe më shumë gjatë Luftës së Parë Botërore (1914–1918). Së pari, sepse ata sapo kishin mbetur të shkëputur nga trangu i Shqipërisë dhe kishin përjetuar pushtimin serbo-malazez të vitit 1912⁴, së dyti, sepse Kosova u nda në dy zona pushtimi austro-hungareze dhe bullgare, ku sidomos në zonën bullgare pozita e shqiptarëve ishte jashtëzakonisht e vështirë. Kjo periudhë u karakterizua nga pasiguri politike dhe shoqërore, si dhe nga intensifikimi i dhunës ndaj popullsisë shqiptare.⁵

Në përfundim të Luftës së Parë Botërore, situata në Kosovë mbeti po aq e rëndë. Serbia, e cila synonte rikthimin e kontrollit mbi Kosovën dhe trevat shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi, veproi me vendosmëri për t'i rimarrë këto territore, të cilat fillimisht u mbajtën nga ushtria franceze dhe më pas iu dorëzuan asaj serbe. Qysh gjatë luftës, Beogradi kishte hartuar plane për zgjerimin e ndikimit të tij në këto zona. Komanda Supreme serbe përpjeqj të tërhiqte shqiptarët në anën e saj duke shfrytëzuar kundërshtimin që ata kishin ndaj forcave bullgare dhe austro-hungareze. Nëpërmjet proklamatave u kërkoheshin shqiptarëve të vepronin kundër ushtrive bullgare, gjermane e austriake dhe të ruanin “qetësinë” në marrëdhënie me serbët, duke iu kujtuar se “nga vetë ata varej fati i tyre”. Këto ishin përpjekje për të siguruar mbështetjen e popullsisë vendase.⁶

Në tetor 1918, Serbia e ripushtoi përfundimisht Kosovën dhe trevat e tjera shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi. Edhe pse shqiptarët organizuan rezistencë të armatosur, kryengritja u shtyp me forcë. Pasojat ishin të rënda: mijëra fshatra shqiptare u dogjën dhe mbi 100.000 shqiptarë u detyruan të largoheshin drejt maleve ose të shpërnguleheshin jashtë Kosovës, kryesisht drejt Shqipërisë.⁷

⁴ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës (KMKK), Dosja (më tej: D.) 28/3, Nr.161, II/1991, Vitit (më tej: V.) 1921, fl.1. Mbi krimet serbe në tokat shqiptare, 12 shkurt 1921; Lush Culaj, *Çështja shqiptare në Konferencën e Parisit 1919-1920*, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2010, 37.

⁵ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Vëllimi I, Akademia e Studimeve Albanologjike-Instituti i Historisë, Tiranë: Botimet albanologjike, 2017; Fitim Rifati, *Kosova gjatë Luftës së Parë Botërore 1914-1918*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2019 etj.

⁶ Skender Lutfiu, *Çështja e shqiptarëve në Jugosllavi në sfondin e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, 1918–1939*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2021.46-54.

⁷ *AQSH*, F. KMKK, D. 28/3, Nr.161, II/1991. Mbi krimet serbe në tokat shqiptare. 12 shkurt 1921.

Në këtë kontekst, pas përfundimit të luftës, në vitin 1918 u krijua Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene⁸ (më vonë Mbretëria e Jugosllavisë). Brenda këtij shteti të ri, Kosova nuk u trajtua si një njësi e veçantë territoriale, por u fragmentua në disa banovina, me qëllim që të zbeheshin përmasat demografike të shqiptarëve.⁹ Jeta politike në Mbretërinë Jugosllave ishte jashtëzakonisht e tensionuar, sidomos pas vrasjes së liderit kroat Stjepan Radiç, në Parlamentin Jugosllav më 1927. Ky incident nxiti mbretin të ndërmerre hapa të menjëhershëm për të stabilizuar situatën, duke suspenduar kushtetutën më 6 janar 1929, shfuqizuar parlamentin dhe ndaluar partitë politike, dhe duke vendosur një regjim autoritar. Ai formoi një qeveri me përfaqësues nga të gjitha krahinat, në krye të së cilës vendosi gjeneralin Zhivkoviç, dhe ky sistem mbeti në fuqi gjatë gjithë vitit 1929. Me miratimin e kushtetutës së re ndryshoi edhe emri i shtetit, nga Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Slllovenëve (SKS) në Mbretëria e Jugosllavisë.¹⁰

Reforma administrative e këtij viti krijoi nëntë njësi territoriale të njohura si banovina, ndër të cilat territori i Kosovës u përfshi në tri banovina: Vardarit, ku bënë pjesë qarku i Gjilanit, Nerodimes (Ferizaj), Graçanica, Kamenica, Podgora, Gora dhe Mali i Sharrit; Zetës, ku hynin qarku i Gjakovës, Pejës, Mitrovicës, Drenicës, Istogut dhe Podrimës; dhe Moravës, që përfshinte qarkun e Vushtrrisë dhe Llapit.¹¹

Kjo ndarje kishte për qëllim jo vetëm të fragmentonte komunitetin shqiptar, por edhe të pengonte organizimin e kryengritjeve dhe aktivitetet

⁸ Mbretëria e SKS u krijua si pasojë e shpërbërjes së katër perandorive të mëdha të kohës: Osmane, Austro-Hungareze, Gjermane dhe Ruse. Krijimi i saj përfaqësonte një proces të ri politik e territorial në Ballkan, që bashkoi Mbretërinë e Serbisë, Mbretërinë e Malit të Zi dhe territore të ndryshme të ish-Perandorisë Austro-Hungareze – përfshirë Sllloveninë, Dalmacinë, Kroacinë, Vojvodinën dhe Bosnjë-Hercegovinën. Në përbërjen e saj u përfshinë gjithashtu edhe vise të tjera që më parë kishin qenë nën sundimin osman, si Maqedonia, Kosova, Sanxhaku i Novi Pazarit dhe territore të tjera shqiptare, të cilat pas Luftërave Ballkanike (1912–1913) kishin kaluar nën kontrollin e Serbisë dhe Malit të Zi. Kështu, themelimi i Mbretërisë SKS më 1918 përbënte një realitet të ri politik, në të cilin popullsia shqiptare e Kosovës u përfshi brenda një shteti të ri, pa u marrë parasysh vullneti i saj politik apo e drejta për vetëvendosje. Joseph Rothschild, *Europa Lindore Qendrore midis dy luftërave botërore*, Tiranë: Dituria, 2004, 199.

⁹ Liman Rushiti, *Ndarje territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës 1878-1941*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2004, 86.

¹⁰ Petrit Imami, *Serbët dhe shqiptarët ndër shekuj*, Vëllimi I, Beograd: Samizdat B92, 2016, 480.

¹¹ Rushiti, *Ndarje territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës*, 86.

kundër qeverisë së Beogradit. Përforcimi i autoritetit u realizua përmes emërimit të ushtarakëve nacionalistë serbë në krye të banovinave dhe përmes influencës së politikanëve të rinj nacionalistë dhe autoritarë, si Vojislav Marinković (kryeministër 1932–1934) dhe Milan Stojadinović, që vinte nga lëvizje me prirje fashiste, duke forcuar politikën shtypëse ndaj shqiptarëve dhe tensionet në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave.¹²

Pozita e shqiptarëve në prag të Luftës së Dytë Botërore ishte jashtëzakonisht e vështirë, kryesisht për shkak të zhvillimit të mangët ekonomik të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare brenda Mbretërisë së Jugosllavisë. Për më tepër, pushteti jugosllav jo vetëm që nuk investoi në këto territore, por veprimi sistematikisht për të zhvendosur popullsinë shqiptare dhe për të zëvendësuar atë me kolonë sllavë.

Gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave, qeveria e Beogradit implementoi reformën agrare me qëllim të shpronësimit të shqiptarëve, duke lehtësuar shpërnguljen e tyre dhe vendosjen e kolonëve sllavë në pronat e tyre. Kështu, reforma agrare dhe kolonizimi u përdorën paralelisht, si mjete për të ndryshuar strukturën etnike në favor të popullsisë sllave, në dëm të shumicës shqiptare që jetonte në Kosovë.¹³ Pra, në periudhën 1918–1941, politika zyrtare e Beogradit synonte sistematikisht shpërnguljen e popullsisë shqiptare nga trojet e veta. Vendimet shtetërore, si ai i vitit 1928 për heqjen e shtetësisë personave që shpërnguleshin në Turqi, ishin pjesë e strategjisë për spastrimin etnik të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare.¹⁴ Si rezultat, nga Kosova u shpërngulën 100.000–150.000 shqiptarë, ndërsa nga e gjithë hapësira shqiptare në Mbretërinë e Jugosllavisë rreth 240.000, megjithëse numri mund të ketë qenë më i lartë.¹⁵ Projektet si “Dëbimi i shqiptarëve” (1937) dhe draft-konventa jugosllavo-turke e vitit 1938 synonin largimin e

¹² Emine Arifi-Bakalli, “Çështja e Kosovës apo çështje lidhur me shqiptarët e Kosovës në parlamentin e Shqipërisë në vitet 1925-1939”, në *100 vjet parlamentarizëm shqiptar*, Tiranë: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, 2020, 82.

¹³ *Arkivi i Instituti të Historisë në Prishtinë* (më tej: *AIHP*). Fondi (më tej: F.) 44, fl.28-29. Dokumente të ndryshme –Ali Hadri, Shtypja nacionale e shqiptarëve; Ramiz Abdyl, “Faktorët që ndikuan në ndryshimin e strukturës socialiste në fshatin e Kosovës (1918-1941)”. Në *Kosova*, nr.15/1986. Prishtinë: Instituti i Historisë, 163; Më gjerësisht shih në: Milovan Obraniq, *Reforma Agrare dhe Kolonizimi në Kosovë (1918-1941)*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2005; Marenglen Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë (1918-1941)*, Tiranë: Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, 1992.

¹⁴ *AJ. 411. 2/30-32*, Cituar sipas Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve*, 151.

¹⁵ Bajrami, *Rrethanat*, 177.

dhjetëra mijëra familjeve shqiptare drejt Turqisë.¹⁶ Marrëveshja e planifikuar për shpërnguljen e 40.000 familjeve myslimane nuk u ratifikua për shkak të faktorëve të jashtëm, si vdekja e Ataturkut, rrëzimi i qeverisë Stojadinoviq dhe shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore.¹⁷

Në përfundim, gjithë kjo periudhë tregon se politika jugosllave ndaj shqiptarëve ishte e orientuar drejt reduktimit demografik të tyre, përmes presionit shtetëror, ligjeve diskriminuese dhe projekteve ndërkombëtare për shpërngulje të detyruar.

Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore

Me pushtimin e Jugosllavisë u bë edhe ndarja e territorit të saj, midis pushtuesve gjermanë, italianë e bullgarë. Në këtë kuadër, edhe Kosova u nda ndërmjet tyre në tri zona të pushtimit. Në fakt, përgatitjet për ndarje kishin filluar para se të ndodhte pushtimi i Jugosllavisë. Kështu, italianët, duke u vendosur si “mbrojtës” të popullit shqiptar, paraqitën pretendimet në emër të krijimit të Shqipërisë së Madhe. Në fillim të vitit 1940, ata krijuan “Komisionin për Rivendikimet Shqiptare”.¹⁸

¹⁶ Çubrilloviq, *Shpërngulja e shqiptarëve*, 14-17; Emine Arifi-Bakalli, “Konventa jugosllavo-turke për shpërngulje e vitit 1938 në funksion të spastrimit etnik të trojeve shqiptare” në *Gjenocidi dhe aktet gjenocidale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga Kriza Lindore e këndeje*, ASHAK, Prishtinë: 1995.

¹⁷ AMEPJ, D.530/2 (B VII -2-), V.1960, fl.17. Relacion: Emigrimi i shqiptarëve jashtë dhe brenda Jugosllavisë; ASHAK, Arkivat në Francë, Arkivi Nacional në Paris, F.MPJ-Paris, Nr. Inv. 562/2, V.1900-1912, fl.110/1-6. Procesverbali i mbledhjeve të komisionit për emigrim.

¹⁸ Komisioni përbehej nga Xhemal Dino, Fejzi Alizoti, Mustafa Kruja, Dhimitër Berati dhe Tahir Shtylla, të cilët fillimisht përgatitën një raport mbi rivendikimet shqiptare. Më pas, si rezultat i rrethanave të krijuara, komisioni u nda në katër grupe apo komitete: 1. Komiteti për Rivendikimet në ish-vilajetin e Janinës; 2. Komiteti për Rivendikimet në ish-vilajetin e Manastirit (ose komiteti i Maqedonisë); 3. Komiteti për Rivendikimet në ish vilajetin e Shkodrës, (ose Komiteti i Kufijve me Malin e Zi); dhe 4. Komiteti për Rivendikimet në ish-vilajetin e Kosovës (ose komiteti për Kosovën). Komiteti për Kosovën me në krye Mustafa Krujen, përbehej nga anëtarët Fuad Dibra, Jashar Erebara, Irfan Ohri, Ramiz Dibra, Rexhep Mitrovica, Q. Begolli, Ahmet Gashi, Tafil Boletini, Asim Jakova, Bedri Pejani, Ismet Kryeziu, Ndoc Sheldia, Dom Gjon Buzuku, Avni Gjilani dhe Hasan Dosti. Mbledhjet e Komisionit u intensifikuan gjatë muajit prill të vitit 1941, pas shkatërrimit të Jugosllavisë dhe Greqisë. Ky komision, më 3 maj, i paraqiti qeverisë italiane respektivisht Ministrisë së Punëve të Jashtme, “Rivendikimet Shqiptare” në një përmbledhje me dokumente dhe shpjegime historike për të gjitha vendbanimet shqiptare. AQSH, F.161, D.101, V.1941. Rivendikimet Shqiptare, përmbledhje dokumentesh, artikuj, harta etj., paraqitur më 3 maj 1941, qeverisë italiane nga Komisioni për Rivendikimet Shqiptare.

Me nismën e ministrit të jashtëm gjerman, Jochim fon Ribentrop, u organizua takimi i Vjenës (18-23 prill 1941) që kishte për qëllim arritjen e marrëveshjes për ndarjen përfundimtare të Jugosllavisë. Në këtë takim morën pjesë homologu i tij italian, Galeaco Çiano, dhe personalitete të tjera të interesuara për ndarjen e Jugosllavisë.¹⁹ Ky takim ishte vendimtar për fatin e territoreve shqiptare, sepse hartoi kufijtë e rinj politikë dhe administrativë në Ballkan. Para takimit, si Gjermania, ashtu edhe Italia kishin përgatitur projektet e tyre për ndarjen e Jugosllavisë. Hartimet italiane, të realizuara për qëllime strategjike dhe politike, parashihnin bashkimin me Shqipërinë të pjesës më të madhe të Kosovës (veçanërisht rajonet e Pejës, Gjakovës, Prizrenit, Gjilanit dhe Ferizajt), të zonave shqiptare në Maqedoninë Perëndimore (Tetovë, Kërçovë, Gostivar, Dibër) si dhe të qarqeve me popullsi shqiptare në Mal të Zi.²⁰ Sipas llogaritjeve italiane, rreth 900.000 shqiptarë do të përfshiheshin në këto territore, çka, sipas tyre, do t'i jepte Shqipërisë një strukturë më të qëndrueshme etnike e territoriale.²¹

Në negociatat gjermano-italiane që pasuan, u arrit një kompromis: pjesa më e madhe e Kosovës do t'i bashkohej Shqipërisë nën administratën italiane, ndërsa Gjermania do të mbante nën kontroll zonat me rëndësi të madhe ekonomike dhe ushtarake, si Mitrovicën me kompleksin minerar të Trepçës.²² Ky vendim nuk ishte i motivuar nga interesi për popullsinë lokale, por nga përfitimet industriale dhe strategjike që ofronte rajoni.

Ndërkohë, Gjermania vendosi që një pjesë e territoreve shqiptare në Maqedoninë e sotme t'ia dorëzohej Bullgarisë, e cila ishte aleate e saj. Këto rajone edhe pse me shumicë shqiptare iu dhanë Bullgarisë, për të forcuar pozitat e saj në gadishull dhe për të shpërblyer rolin e saj në luftë. Kjo zgjidhje shkaktoi zhgënjim të thellë te shqiptarët e atyre viseve, të cilët prisnin bashkimin me Shqipërinë.²³

¹⁹ Documents on the German Foreign Policy 1918-1945, (më tej: *DGFP*), Series D (1937-1945), Vol. XII, The War Years, February 1 – June 22 1941, Washington: United States Government Printing Office, 1962, Dok. 378, 595.

²⁰ Romeo Gurakuqi, *Shqipëria dhe Tokat e Lirume*, 1939-1946, Durrës: Botimet Jozef, 2018, 284-285.

²¹ Haxhi Ademi, *Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2021, 125.

²² *Arkivi i Institutit të Historisë Tiranë*, (më tej: *AIHT*), Fondi (më tej: F.) F.A-V. Dosja (më tej: D.) 38, fl.23.

²³ *AIHT*, F.A-V. D.195, fl.1. Mbi çështjen e kufijve shqiptaro-jugosllav dhe shqiptaro-grek. Departamenti i kërkimeve, Ministria e Punëve të Jashtme e Britanisë, 30 qershor 1944.

Pas marrëveshjeve të Vjenës, territoret shqiptare u fragmentuan në tri zona pushtimi:

Zona italiane: Përfshinte pjesën dërrmuese të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare. Italia synonte të krijonte një “Shqipëri të Madhe” nën kontrollin e saj, me qëllim forcimin e ndikimit politik dhe ushtarak në Ballkan. Pra, bashkimi i pjesës më të madhe të Kosovës, dhe jo vetëm, me shtetin amë, në gusht të vitit 1941, nuk u realizua nga shqiptarët, edhe pse ata e aspironin një bashkim të tillë.²⁴ Madje, një pjesë e madhe e udhëheqjes politike shqiptare në Kosovë as që ishin në dijeni për takimin e Vjenës. Këtë e dëshmon memorandumi i Ferhat Dragës, i datës 26 prill 1941.²⁵

Zona gjermane: Shtrihej kryesisht në veri të Kosovës dhe përfshinte rajonet industriale dhe minerare, si Mitrovica, Vushtrria dhe Podujeva. Këto territore mbetën jashtë administrimit shqiptar për shkak të interesit të drejtpërdrejtë ekonomik të Gjermanisë.

Zona bullgare: Përfshinte krahinat lindore dhe juglindore të Kosovës dhe pjesë të Maqedonisë Perëndimore ku shqiptarët ishin shumicë. Bullgaria vendosi administrimin e saj në këto zona duke ndjekur politika të asimilimit dhe të unifikimit administrativ me shtetin bullgar.²⁶

Vija e demarkacionit ndërmjet Italisë, Gjermanisë dhe Bullgarisë nuk u përcaktua qartë dhe nuk mbeti e qëndrueshme. Negociatat mes shteteve pushtuese për ndarjen e sferave të interesit u zvarritën dhe, në thelb, mbetën të pazgjidhura gjatë gjithë periudhës së pushtimit.²⁷

Kjo ndarje territoriale, e diktuar nga interesat e shteteve pushtuese dhe jo nga aspiratat e popullsisë lokale, krijoi një realitet të ri politik e administrativ në rajon. Megjithëse një pjesë e Kosovës dhe trojeve shqiptare u bashkuan me Shqipërinë, fragmentimi i territoreve shqiptare dhe lënia e disa prej tyre nën administratë të huaj shkaktuan pakënaqësi të thellë te shqiptarët, të cilët synonin një bashkim të plotë kombëtar.

²⁴ *DGFP*, Series D (1937-1945), Vol. XII., Dok. 291, fl. 487.

²⁵ Memorandumi i Ferhat Dragës, në mënyrë të veçantë hidhte poshtë pretendimet bullgare për Shkupin dhe Manastirin. Sipas tij, trekëndëshi Shkup-Kumanovë-Preshevë, në vitin 1918, kishte rreth 95% shqiptarë. Luca Micheletta, *La resa dei conti, Il Kosovvo, l'Italia e la dissoluzione della Jugoslavia (1939-1941)*, Edizioni Nuova Cultura, Roma: 2008, 131-1138, cituar sipas Gurakuqi, *Shqipëria*, 291.

²⁶ *AQSH*, F.161, D.71, V.1943. Raporti i Kryesisë së Komisionit për përcaktimin e kufirit shqiptaro-bullgar.

²⁷ *Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit* (më tej: *AIDSSH*), Fondi (më tej: F.) 6, Dosja (më tej: D.) 128, Viti (më tej: V.) 1946, fl. 22. Raport mbi Kosovën.

Pra, ndarja e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte rezultat i drejtpërdrejtë i strategjive ushtarake dhe politike të fuqive të Boshtit, të cilat, pas pushtimit të Jugosllavisë – ku bënte pjesë edhe Kosova – e shpërndanë territorin sipas interesave të tyre. Me kapitullimin e Italisë në vitin 1943²⁸ dhe të Bullgarisë në vitin 1944,²⁹ Gjermania mori kontrollin e plotë mbi hapësirat shqiptare, duke e mbajtur nën administrimin e saj deri në përfundim të luftës.³⁰

Kur Luftës së Dytë Botërore po i afrohej fundi, skena politike shqiptare në Kosovë ishte thellësisht e përçarë. Një pjesë e elitës politike besonte se bashkëpunimi me gjermanët mund të çonte drejt formimit të një shteti të unifikuar shqiptar, ndërsa pjesa tjetër ishte e bindur se pushtimi duhej kundërshtuar dhe se pas luftës duhej respektuar parimi i vetëvendosjes, i shpallur nga aleatët dhe i mbështetur nga forcat komuniste shqiptare dhe jugosllave. Megjithëse synimi për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë ishte i përbashkët, rrugët dhe mbështetjet politike për ta arritur atë ishin të ndryshme: njëra palë mbështetej në forcat kombëtare tradicionale, ndërsa tjetra në strukturat komuniste të lëvizjes antifashiste.

Këto dallime u reflektuan edhe në organizimin politik të kohës: Lidhja e Dytë e Prizrenit (1943), e cila kishte për synim mbrojtjen e tokave shqiptare dhe bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, dhe Konferenca e Bujanit (31 dhjetor 1943 – 2 janar 1944), e organizuar nga forcat nacionalçlirimtare shqiptare dhe jugosllave, që miratoi një rezolutë historike, duke njohur të drejtën e popullit shqiptar të Kosovës për vetëvendosje dhe për bashkim me Shqipërinë pas luftës. Në rezolutë, ndër të tjera, thuhej se populli shqiptar i Kosovës gjatë gjithë jetës ka luftuar për t’u bashkuar me mëmëdheun e tij, Shqipërinë. Për më tepër, në Rezolutën e nxjerrë në Konferencën e Parë Nacionalçlirimtare për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit, thuhej: *“Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit është një krahinë e banuar në shumicë nga populli shqiptar, i cili si gjithmonë ashtu edhe sot dëshiron me u bashku me Shqipërinë”*.³¹

²⁸ AQSH, F.178, D.I-2596, V.1941, fl.2. Dekreti i Viktor Emanuelit III, Romë, 12 gusht 1941.

²⁹ ZDPN, Tom XIII, Knjiga I, Dokumenti KraljevineItaliqe 1941, Dok. 14, fl.43; *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. IV, 129-130; Shatri, *Kosova*, 20.

³⁰ Ademi, *Kosova*, 240-247.

³¹ AMEPJ, D.683, V.1963, fl.15. Gjendja e popullsisë shqiptare në Kosovë; AIDSSH, F.6, D.59, V.1945, fl.5. Rezolucioni i Konferencës së Parë të Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovë dhe Rrafshin e Dukagjinit.

Më tej, thuhej se, “...rruga që duhej ndjekur për të realizuar aspiratat kombëtare të popullit të Kosovës është rruga e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë, (jo të Shqipërisë!) në luftë kundër pushtuesit nazist”. Përmes kësaj lufte të përbashkët me të gjithë popujt e tjerë, pra edhe populli shqiptar do të kishte mundësi të vetëvendoste për fatin e tij, me të drejtën deri në shkëputje. Për më tepër, u deklaruan se lufta e tyre ishte kundër “pushtuesve nazistë dhe mercenarëve të tyre”, dhe më tej vazhdon se kjo do të ishte e vetmja mënyrë që ata të fitojnë “lirinë e të gjithë popujve, duke përfshirë edhe popullin shqiptar [...] duke vendosur për fatin e tyre me të drejtën për vetëvendosje.”³²

Siguri për këtë ishte UNÇ-ja e Jugosllavisë dhe UNÇ-ja e Shqipërisë dhe Aleatët e Mëdhenj: Anglia, Amerika dhe Bashkimi Sovjetik (Karta e Atlantikut, Konferenca e Moskës^{33*} dhe Konferenca e Teheranit³⁴).

Ndërkohë, në planin jugosllav, zhvillimet politike shkonin në kah krejt tjetër. Mohimi i të drejtave të shqiptarëve, veçanërisht në mënyrë të theksuar, u bë në Konferencën e Dytë të Këshillit Antifashist Nacional Çlirimtar të Jugosllavisë (AVNOJ-Antifašističko Vijeće Narodnog Oslobođenja Jugoslavije), që i zhvilloi punimet në Jajcë të Bosnjës,³⁵ më 29 nëntor 1943.³⁶ Në këtë konferencë, Komiteti Qendror u shndërrua në një organ ekzekutiv të shtetit federal. Sipas vendimeve që u morën në këtë konferencë, shqiptarët e Kosovës u vendosën në pozitë jo të favorshme brenda shtetit federativ të përbërë nga gjashtë republika sllave, andaj pikërisht për shkak të mungesës së shqiptarëve në këtë mbledhje dhe vendimeve të marra aty, shqiptarët organizuan të mbajnë një Konferencë të veçantë në Bujan.³⁷ Anëtarët e

³² ASHAK, F. Komiteti Krahinor i LK të Kosovës, Njësia organike. Shtypi gjatë Luftës së Dytë Botërore, V.1937-1944, Nr. i kutisë 37, Lirija, nr.12,13,14, fl.5.

³³ Në Konferencën e Moskës në parim është pranuar bashkëpunimi si në luftë ashtu dhe në paqe i të gjitha kombeve pa përjashtime, pra edhe i Shqipërisë. *AIHT*, F.A-VIII, D.110, fl.40, Nr.inv.1482, Lajme nga radiostacionet e Moskës, Londrës, Amerikës – Radio Amerika, më 10 dhjetor 1943.

³⁴ Në Konferencën e Teheranit, që u mbajt menjëherë pas Konferencës së Kajros, të tre Aleatët u morën vesh që partizanët në Jugosllavi duhej të mbështeteshin me furnizime e pajisje në masën më të madhe të mundshme. Aty nuk u përmend Shqipëria, por ky vendim ishte në favor të partizanëve të Titos. Shih në: *AIHT*, F.A-VIII, D.110, fl.40, Nr. inv.1482, Lajme nga radio stacionet e Moskës, Londrës, Amerikës – Radio Amerika, më 10 dhjetor 1943.

³⁵ Në Jajcë nuk ishin të pranishëm përfaqësuesit e Maqedonisë, as dhe përfaqësuesit e Serbisë të cilët ishin për monarki. Pirjevec, *Tito dhe shokët*, 165.

³⁶ Jože Pirjevec, *Tito dhe shokët*, Tiranë: “Botart” 2020, 165.

³⁷ Sipas studiueses Lalaj, “...në prag të Konferencës së Bujanit, vendimet e Konferencës së

Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë ishin në dijeni (përmes radios “Jugosllavia e Lirë”) për vendimet që u morën në Mbledhjen e AVNOJ-it në Jajcë, vendime që përjashtuan shqiptarët si popull duke i trajtuar pakicë kombëtare.³⁸

Thelbi i kësaj konference ishte Jugosllavia e bashkuar mbi baza federative, ndërsa parimi i vetëvendosjes që u proklamua^{39*} ishte vetëm propagandë. Andaj, ky veprim në thelb ishte një vazhdim i politikës tradicionale serbe në raport me Kosovën. Për më tepër, përjashtimi i shqiptarëve nga AVNOJ-oni, mund të konsiderohet se ishte në kundërshtim me parimin e vetëvendosjes së popujve në bazë të Kartës së Atlantikut (1941). Përjashtimi i shqiptarëve në Jajcë, aty ku përfaqësoheshin nacionalitetet tjera të Jugosllavisë, për shqiptarët e Kosovës ndikoi që të përcaktoheshin dhe të proklamoheshin parimin e vetëvendosjes mbi bazën e Atlantikut. Sipas një interviste të delegatit dhe nënshkruesit të Rezolutës, Sadik Bekteshit, njëra nga arsyet bazike se pse u thirr dhe u organizua Konferenca e Bujanit është injorimi dhe përjashtimi i shqiptarëve nga mbledhja e AVNOJ-it.⁴⁰

Pra serbët kishin plane të tjera për të ardhmen e Kosovës dhe për popullsinë shqiptare. Edhe pse përbënin një përqindje të vogël të popullsisë së Kosovës,

*Dytë të AVNOJ-it nuk u ishin dërguar as KK dhe Shtabit Ushtarak të Kosovës, sipas saj nga dokumentet del se, asnjë nga drejtuesit krahinorë nuk ishin informuar plotësisht mbi Konferencën e Dytë të AVNOJ-t, madje as Paval Jovanoviq, i cili ishte i vetmi që mbante lidhjet me KK me KQ të PKJ-së”. Më gjerësisht shih: Ana Lalaj, *Dosjet e Luftës*, Tiranë: Toena, 2014, 209.*

³⁸ *AIHT*, F.A-VIII, D.334, fl.13. Fronti antifashist dhe roli i tyre në luftën çlirimtare të popujve të Ballkanit.

³⁹ Premtimi i proklamave të PKJ-së gjatë vitit 1941 ishte mobilizimi i popullsisë shqiptare dhe e popujve të tjerë në Kosovë dhe zonën e pushtimit bullgar për një kryengritje të armatosur kundër pushtuesve dhe bashkëpunëtorëve të tyre, me qëllim çlirimin nga okupimi dhe mbrojtjen e të drejtave të popullit, sipas orientimeve të Partisë Komuniste Jugosllave. Në thelb, prej tyre premtohet lufta e përbashkët për çlirim dhe vetëvendosje. Idriz Halabaku, *Lëvizjet Nacionalçlirimtare në zonën okupuese bullgare të Kosovës (1941-1944)*, (Punim i magistraturës), Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 1977, 7; Proklama e 2 janarit 1944 u lëshua nga Komanda e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste Jugosllave, me qëllim mobilizimin e shqiptarëve dhe popujve të tjerë të Jugosllavisë në një front të përbashkët kundër okupatorëve gjermanë dhe fashistë. Ajo nënvizonte se liria dhe e drejta për vetëvendosje mund të siguroheshin vetëm përmes luftës së armatosur të përbashkët, me mbështetjen e Aleatëve të Mëdhenj – Anglisë, SHBA-së dhe Bashkimit Sovjetik – si dhe të UNÇ-së së Shqipërisë dhe UNÇ-së jugosllave. *ASHAK*, F. Komiteti Krahinor i LK të Kosovës, Njësia organike. Shtypi gjatë Luftës së Dytë Botërore, V.1937-1944, Nr. i kutisë 37, Lirija, Nr.15,16,17,18, fl.5, shkurt- maj 1944.

⁴⁰ Sadik Bekteshi, Intervistë, “Dardania”, Tiranë, nr.2 janar 1993, f. 5.

serbët dhe malazezët, shumica prej të cilëve ishin kolonë të vendosur pas vitit 1912, gëzonin një pozitë dukshëm më të favorshme sesa shqiptarët, të cilët përbënin shumicën dërrmuese të popullsisë. Kjo për shkak se ata mbështeteshin nga politika shtetërore e Beogradit, e cila kishte për qëllim spastrimin etnik të Kosovës dhe kolonizimin e saj me element sllav. Këto synime ishin hartuar në projektet ideologjike të Vasa Çubrilloviqit, fillimisht në memorandumun “Shpërngulja e shqiptarëve” të mbajtur më 7 prill 1937 në Klubin Kulturor Serb, dhe më pas në elaboratin “Problemi i pakicave në Jugosllavinë e re” të datës 3 nëntor 1944. Në këtë të fundit, Çubrilloviqi i konsideronte pakicat kombëtare gjermanët, hungarezët, shqiptarët, italianët dhe rumunët si përgjegjëse për pozitën e tyre, duke pohuar se ato “vetë i kanë mohuar të drejtat e tyre qytetare, pasi janë paraqitur haptazi si armiq të shtetit në të cilin jetojnë”. Sipas tij, “këto minoritete duhet të largohen nga shteti ynë, sepse këtë e kanë merituar”.⁴¹

Andaj, përfundimi i Luftës së Dytë Botërore nuk solli asnjë ndryshim pozitiv për shqiptarët jashtë kufijve të Shqipërisë. Përkundrazi, pas vitit 1945, forcat jugosllave shfrytëzuan me ashpërsi situatën politike dhe ushtarake, me qëllim ndryshimin e strukturës etnike të Kosovës. Kjo u realizua përmes veprimeve represive dhe presioneve të vazhdueshme politike, duke ndjekur një platformë shtetërore të përgatitur në Beograd, e cila synonte asimilimin dhe nënshtrimin politik të shqiptarëve. Procesi i aneksimit, i realizuar në kundërshtim me parimin e vetëvendosjes dhe me mohimin e të drejtave kombëtare të shumicës shqiptare, shënoi fillimin e një periudhe të gjatë shtypjeje politike dhe kombëtare. Kjo situatë nxiti rezistencën e pandërprerë shqiptare, e cila me forma të ndryshme dhe intensitet të ndryshueshëm, vazhdoi nga viti 1945 deri në fund të shekullit XX, duke mbetur një nga çështjet më të ndërlikuara të historisë moderne të Kosovës.

Procesi i aneksimit të Kosovës

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, situata politike në Kosovë u karakterizua nga zhvillime të ndërlikuara dhe tensione të forta midis aspiratave kombëtare shqiptare dhe politikave hegjemoniste të Jugosllavisë, me theks të veçantë të Serbisë.

⁴¹ Vaso Çubrilloviq, *Shpërngulja e shqiptarëve*, botuar në: “Zëri i Kosovës”, organ i lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi, ShBA, 1982, 5.

Në këtë kontekst, Kosova dhe viset e tjera me popullsi shqiptare u gjendën në një pozitë gjeopolitike tejet të pafavorshme. Megjithëse popullsia shqiptare kishte dhënë një kontribut të rëndësishëm në luftën antifashiste, ajo u përball me pasoja të ashpra politike: u mohua e drejta për vetëvendosje dhe për bashkim me Shqipërinë, siç ishte sanksionuar në Rezolutën e Konferencës së Bujanit, ndërkohë që territori shqiptar u fragmentua dhe u integrua në katër njësi të ndryshme të Federatës Jugosllave: Kosovë, Maqedoni, Serbi dhe Mal të Zi. Në optikën historike, ky fragmentim territorial përbën një akt të rëndësishëm politik dhe juridik që ilustron shkeljen e parimeve të vetëvendosjes të përcaktuara në Kartën e Atlantikut dhe në parimet e luftës antifashiste. Rrjedhimisht, popullsia shqiptare u përball me dhunën e shtetit serb dhe të ideologjisë komuniste, e cila përdori mjete represive si shantazhi politik, dhuna institucionale dhe asgjësimi i strukturave kombëtare, nën retorikën e “mbrojtjes së pushtetit popullor”.

Proceset e vendimmarrjes u zhvilluan në mënyrë të imponuar, pa pjesëmarrjen e përfaqësuesve legjitimë shqiptarë, duke prodhuar një realitet politik të padrejtë dhe të njëanshëm. Në këtë kontekst, viti 1945 paraqet një moment kritik për Kosovën, ku në vend të çlirimit dhe realizimit të të drejtave kombëtare, ndodhi rivendosja e një forme të re të kontrollit shtetëror, e cila e shndërroi Kosovën në objekt të aneksimit administrativ dhe politik të Serbisë brenda strukturës federale të Jugosllavisë.⁴²

Procesi i aneksimit të Kosovës nuk ishte një veprim i rastësishëm apo momental, por një strategji e mirëfilltë dhe planifikuar me kujdes që nga momenti kur u bënë përpjekjet e para për të arritur marrëveshjen midis Këshillit Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë (KNÇJ) dhe qeverisë mbretërore jugosllave në emigracion. Këto përpjekje dhe bisedime diplomatike u konkretizuan me nënshkrimin e “Marrëveshjes Josip Broz Tito dhe Ivan Shubashiq”^{43*}, një marrëveshje për krijimin e një uniteti politik dhe qeverisës në Jugosllavi pas Luftës së Dytë Botërore, duke bashkuar forcat komuniste që kontrollonin terrenin dhe qeverinë mbretërore në ekzil, për të shmangur luftën civile dhe për të krijuar një qeveri të përbashkët tranzitore.⁴⁴

⁴² Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2012, 97.

⁴³ Ivan Šubašić – ishte politikan kroat, kryeministër i qeverisë jugosllave në emigracion (1944–1945) dhe pjesëmarrës në marrëveshjet me Titos për bashkimin e forcave partizane.

⁴⁴ Muhamet Shatri, “Copëtimi i trevave etnike shqiptare në Jugosllavi. Aneksimi i Kosovës nga Serbia 1945,” *Kosova*, nr. 27 (2005), 112.

Në Beograd, çështja e Kosovës u trajtua si çështje e mbyllur në forume të larta politike dhe ushtarake, ku u morën vendime të njëanshme për statusin e saj. Më 2 shtator 1944, Shtabi Kryesor i Ushtrisë Nacionalçlirimtare (UNÇ) dhe Autoriteti Politiko-UShtarak i Kosovës (AP) u vunë zyrtarisht nën komandën e Shtabit Kryesor të UNÇ-së dhe AP-së së Serbisë, në bazë të urdhrimit të Shtabit Suprem të UNÇ-së dhe APJ-së. Më pas, çështja e Kosovës u trajtua edhe në mbledhjet e Kuvendit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Serbisë (9–12 nëntor 1944), si dhe në mbledhjen e Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar të Serbisë, në dhjetor të po atij viti.⁴⁵ Në këto mbledhje nuk pati diskutime të hapura, por u morën vendime të drejtpërdrejta, sipas të cilave, Kosova duhej të përfshihej si pjesë e Serbisë, duke përjashtuar çdo mundësi shqyrtimi për status autonom apo për vetëvendosje. Ky vendim krijoi tension dhe pakënaqësi të madhe te popullsia shqiptare.

Dhuna e shtetit serbo-jugosllav u shtua me depërtimin e njërive partizane serbe, malazeze dhe maqedonase, që ushtruan terror mbi shqiptarët. Për pasojë, në fund të vitit 1944 dhe fillim të 1945, popullsia shqiptare u ngrit masivisht për t'iu kundërvënë këtij represioni dhe politikave të PKJ-së ndaj tyre.⁴⁶ Gjatë hyrjes së forcave jugosllave në Kosovë popullsia civile shqiptare u përball me krime të rënda dhe dhunë sistematike. Dokumentet e kohës dëshmojnë se vetëm në Skenderaj u vranë 250 persona të mbytur me sëpata dhe bajoneta, ndërsa në Prekaz u pushkatuan 18 veta.⁴⁷ Ekzistojnë të dhëna të shumta dhe të pakontestueshme që dëshmojnë krimet e kryera nga forcat serbe dhe maqedonase ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë, gjatë depërtimit të tyre në këtë territor.⁴⁸

Kështu, udhëheqësia jugosllave, përmes Shtabit Suprem të Ushtrisë Jugosllave dhe Shtabit Kryesor të Serbisë, urdhëroi më 17 janar 1945 mobilizimin e 10.000 rekrutëve shqiptarë për t'i dërguar në frontin e Sremit, duke përdorur strategjinë e spastrimit etnik dhe largimit nga Kosova të forcave

⁴⁵ Sabile Keçmezi-Basha, *Kosova 1945-1990*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2017, 56.

⁴⁶ *AMEPJ*, D.1140/1, V.1963, fl.115.

⁴⁷ *AMEPJ*, D.514, V.1959, fl.1. Për krimet e ndodhura në Drenicë dhe gjithë Kosovën, në përfundim të LDB mësojmë dhe nga një dokument tjetër. *AMEPJ*, D.683, V. 1965, fl.8, Gjendja e popullsisë shqiptare në Kosovë.

⁴⁸ Për një trajtim më të detajuar të krimeve dhe represionit të ushtruar ndaj popullsisë shqiptare në përfundim të Luftës së Dytë Botërore – përfshirë masakrat, ekzekutimet pa gjyq, zhdukjet, burgosjet masive, si dhe dhunën e ushtruar nga njësitë ushtarake dhe policore serbe, malazeze e maqedonase gjatë depërtimit të tyre në Kosovë – shih: Ademi, *Kosova*, 352–356.

shqiptare më të afta për luftë.⁴⁹ Këto ngjarje krijuan një situatë emergjente dhe shtynë shqiptarët të organizoheshin për mbrojtje, duke çuar në formimin e Brigadës së Drenicës më 20 nëntor 1944, në Kuvendin e Polacit, me pjesëmarrjen e rreth 200 delegatëve nga vise të ndryshme të Kosovës dhe me kryesi Shaban Palluzha, Miftar Bajraktari dhe Halil Haxhia.⁵⁰ Brigada u themelua si një lëvizje politike dhe ushtarake për çlirim dhe bashkim kombëtar, me detyrën për të mobilizuar qytetarët dhe për të informuar aleatët perëndimorë mbi situatën dhe qëllimet e saj. Brigada e VII-të, e njohur ndryshe si Brigada e Shaban Palluzhës, u mobilizua me 7.500 luftëtarë, por udhëtimi i saj u pasua nga kundërshtimi i popullsisë lokale dhe refuzimi i vetë luftëtarëve për t'u nisur drejt frontit.⁵¹ Në rrugën nga Drenica për në Podujevë, banorët e zonës paralajmëruan luftëtarët se po dërgoheshin për t'u vrarë, ndërsa gratë dhe fëmijët e tyre mbeteshin të pambrojtur. Pavarësisht presionit të shtetit jugosllav, Shaban Palluzha dhe luftëtarët e tij refuzuan të niseshin, duke treguar qartë rezistencën ndaj politikës së dhunshme dhe antishqiptare të forcave komuniste jugosllave.⁵² Për më tepër, brigada e Drenicës jo vetëm që nuk pranoi të shkonte në Banat, por filloi të shpërndahej për t'u rikthyer në Drenicë.⁵³ Faktorët e sipërhënuar shkaktuan rezistencë masive të armatosur, duke e shndërruar kryengritjen në një revoltë gjithëpopullore në Drenicë dhe në zona të tjera të Kosovës, në fund të vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945.

Politika zyrtare e Beogradit vendosi administrimin ushtarak në vend, nën drejtimin e Josip Broz Titit. Më 7 shkurt 1945, në Beograd u thirrën individë të besuar nga Komiteti Qendror i PKJ-së, si Savo Drleviq, Gjuro Medenica dhe Kristo Filipoviq, për të udhëhequr pushtetin 'popullor', por në realitet u vendos pushteti ushtarak, i përbërë kryesisht nga serbo-malazezë, pa përfaqësim të shqiptarëve.⁵⁴ Me dekretin nr. 31 të datës 8 shkurt 1945, Tito vendosi Administrimin Ushtarak në Kosovë, duke emëruar komandantë dhe

⁴⁹ Bajrami, "Si u okupua Kosova nga Jugosllavia", 93.

⁵⁰ Kuvendit të Drenicës i parapriu kuvendi i mbajtur më 23 tetor 1944 në Llaushë të Skenderajit, dhe pjesëmarrës në këtë kuvend ishin personalitete nga Drenica dhe me gjerë: Nuri Bashota, *Halim Spahia*, Prishtinë: "KGT", 2012, 265-266.

⁵¹ Hakif Bajrami, "Si u okupua Kosova nga Jugosllavia dhe me kërkesë të kujt, më 1945", në *Ripushtimi Jugosllav i visve shqiptare dhe Lufta e Drenicës (1944/1945)*, 93.

⁵² Veton Surroi, *Fadil Hoxha në veten e parë*, Prishtinë: "Koha", 2010, 244.

⁵³ *AMEPJ*, D.202 (B/VII-2), V.1949, fl.27-30. Raport mbi gjendjen e krijuar në Kosovë në ditët e çlirimit, përgatitur nga Shaban Haxhia- Demolisi, Tiranë, 11 shkurt 1949.

⁵⁴ Hakif Bajrami, "Pasojat e diktaturës ushtarake për shqiptarët", *Epoka e Re*, Prishtinë, 22.10.2015, 1.

komisarë ushtarakë serbë dhe malazezë në Shtabin Operativ dhe Divizionin 52. Ky administrim ishte i drejtpërdrejtë nën varësinë e Komandës Supreme të UNÇ-së dhe NJPJ-së dhe synonte krijimin e strukturave ushtarake-shtetërore me tri divizione dhe rreth 30.000 luftëtarë,⁵⁵ duke forcuar kontrollin e Beogradit mbi Kosovën dhe duke eliminuar përfaqësimin shqiptar.

Akti i vendosjes së pushtetit ushtarak në Kosovë u konfirmua në prag të Konferencës së Jaltës, në të cilën pritej të merreshin vendime tejet me rëndësi për përcaktimin e kufijve të Jugosllavisë dhe përgjithësisht për botën e pasluftës.⁵⁶ Në fakt, Deklarata e Konferencës së Jaltës^{57*} (4-11 shkurt 1945) rikonfirmoi kufijtë e Jugosllavisë së paraluftës, duke e lënë kështu Kosovën dhe viset e tjera shqiptare nën Jugosllavi.⁵⁸

Në këtë periudhë tejet të ndërlikuar për shqiptarët që jetonin nën juridiksionin e Federatës së sapoformuar Jugosllave, vetëm dhjetë ditë pas vendosjes së Administratës Ushtarake në Kosovë, më 18 shkurt 1945, u organizua një takim i rëndësishëm politik në Beograd, me ftesë të Komandës Supreme dhe të Shtabit Suprem të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë. Në këtë mbledhje morën pjesë përfaqësuesit kryesorë të Kosovës: Fadil Hoxha, në cilësinë e përfaqësuesit politik dhe ushtarak të Kosovës, të Kosovës dhe Metohisë (së Rrafshit të Dukagjinit H.A.)^{59**} dhe Milladin Popoviqi, në

⁵⁵ ZDPN, Tom II, Knjiga 15, Dok. 96, 166.

⁵⁶ Sabit Sylja, “Drenica në fund të Luftës së Dytë Botërore”, në *Studime për historinë ushtarake*, nr.8, Tiranë: Organ i Institutit të Studimeve të Historisë Ushtarake, 2014, 71.

⁵⁷ Takimi në Jaltë ishte takimi i dytë nga tre takimet aleate gjatë Luftës së Dytë Botërore. Përfaqësuesit e krerëve aleate Franklin D. Roosevelt (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), Winston Churchill (Mbretëria e Bashkuar) dhe Josif Stalin (BRSS). Temat e konferencës ishin kryesisht ndarja e Gjermanisë dhe shpërndarja e energjisë në Evropë pas përfundimit të luftës. BRSS dhe të Britanisë së Madhe në Konferencën e Jaltës gjatë diskutimit midis tyre nuk e përmendën fare çështjen e Shqipërisë, ndërsa Kosovën e konsideronin si çështje të brendshme të Jugosllavisë. Në Jaltë fitimtarë dolën Britania e Madhe dhe Bashkimi Sovjetik dy fuqitë më të interesuara për çështjen e Evropës Juglindore, ndërsa humbës dolën SHBA, të cilat pas Jaltës aplikuan teorinë e izolacionit, duke humbur ndikimin, në Evropën Juglindore. Më gjerësisht shih në: Arthur Conte: *Die Teilung der Welt – Jalta 1945*, Verlag Rauch, Düsseldorf :1965; Zogaj, *Kritikë*, 87-88; Hamit Kaba, “Kufijtë e Shqipërisë në projektet e Aleatëve të Mëdhenj gjatë Luftës së Dytë Botërore”, në *Studime historike*, nr.3-4/2015. Tiranë: Akademia e Shkencave e RSH& Instituti i Historisë, 223.

⁵⁸ Hamit Kaba, “Kufijtë e Shqipërisë në projektet e Aleatëve të Mëdhenj gjatë Luftës së Dytë Botërore”, në *Studime historike*, nr.3-4/2015. Tiranë: Akademia e Shkencave e RSH& Instituti i Historisë, 223.

⁵⁹ Në fillim të shek. XX, nga studiuesit e njohur serbë St. Novakoviç dhe J. Cvijiq, filloj të përdorej termi *Metohia*, te cilët duke mos u mbështetur në burimet historike, ngritën tezën

rolin e përfaqësuesit të Partisë Komuniste Jugosllave për Kosovën.⁶⁰ Takimi u zhvillua në prani të Millovan Gjillasit dhe Aleksandar Rankoviçit, dy ndër figurat më të fuqishme të aparatit politik dhe të strukturave të sigurisë së Jugosllavisë së pasluftës. Ky takim përbën një moment të rëndësishëm në procesin e pozicionimit politik të Kosovës brenda Federatës Jugosllave, pasi në të u diskutuan çështjet themelore të organizimit administrativ dhe të ardhmes juridiko-politike të Krahinës, në përputhje me synimet e Beogradit për ta integruar Kosovën nën juridiksionin e Serbisë. Mes diskutimeve për të ardhmen e statusit të Kosovës, tensionet u bënë të dukshme. Pas një përshëndetjeje të ftohtë, Millovan Gjillasi iu drejtua Milladin Popoviçit në gjuhën serbe me fjalët: “*Eja Milladin, të ndajmë Kosovën sikur Sanxhakun.*”⁶¹ Kjo shprehje nënkuptonte qartë një ndarje territoriale dhe politike që do të kishte pasoja të mëdha për shqiptarët. Por, Milladin Popoviç iu përgjigj me vendosmëri: “*Jo shoku Gjillas, Kosova nuk është Sanxhaku... ne nuk ndihemi si pushtues, por si çlirimtarë.*” Ky kundërshtim i fuqishëm tregonte për diferencat e thella dhe interesat diametralisht të kundërta mes palëve.⁶²

Në të njëjtën ditë, në Beograd u mbajt edhe një takim tjetër i rëndësishëm, ku ishin të pranishëm Aleksandër Rankoviç, Eduard Kardel, Sreten Zhujoviç, Svetozar Vukmanoviç-Tempo, Bllagoja Nishkoviç, Milentije Popoviç, Milladin Popoviç dhe Fadil Hoxha.⁶³ Gjatë këtij takimi u shfaqën edhe më qartë dallimet dhe pozicionet kontradiktore për të ardhmen e Kosovës. Në fillim u diskutua një propozim i cili parashikonte ndarjen e Kosovës në mes Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, ku krahinat shqiptare të ndaheshin dhe

për ekzistimin e emërimit *Metohia*, që kishte kuptimin e territorit midis Prizrenit dhe Pejës. Këtë tezë e mbështesnin në faktin që termi “metohion”, përkatësisht “metohija” në gjuhën greke ka kuptimin e pronës së manastireve dhe në këtë aspekt, shumë fshatra të territorit në fjalë kanë qenë pronë manastiresh. Me këtë tezë, pa ofruar argumente shkencore, kanë sjellë habi tek bota shkencore, sepse territori i Pejës, i Gjakovës dhe i Prizrenit të sotëm, deri në vitin 1945, nuk ka pasur asnjëherë kuptimin gjeografik *Metohia*, por që nga shek. XV deri më 1945, ruante konceptin gjeografik *Rrafshi i Dukagjinit*, apo shkurt Dukagjin, Jahja Drançolli, “Rrënjët e qytetërimit ilir -shqiptar në Kosovë”, në *Buletini*, Nr.XXV-1995, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës- Fakulteti Filozofik, 1998, 175.

⁶⁰ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi IV, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë & Instituti i Historisë, Toena, 2008, 341.

⁶¹ Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, Prishtinë: Instituti i Historisë 1997, 302.

⁶² Po aty.

⁶³ Sylja, *Shteti shqiptar*; 97.

të kalonin nën varësinë administrative të këtyre tri njësive federale.⁶⁴ Ky propozim kishte një qëllim të qartë strategjik: të parandalonte krijimin e një entiteti të vetëm shqiptar brenda Federatës Jugosllave, gjë që do të mund të shërbente si bazë për themelimin e një republike shqiptare autonome. Për më tepër, ndarja administrative do të shërbente për të fragmentuar dhe dobësuar identitetin dhe aspiratat kombëtare shqiptare, duke e përplasur këtë popull në tri administrata të ndryshme.

Megjithatë, ky propozim u kundërshtua fuqishëm nga dy përfaqësuesit kryesorë të Kosovës, Fadil Hoxha dhe Milladin Popoviqi, të cilët mbronin hapur aspiratat e popullit shqiptar për të mbajtur Kosovën si një njësi të vetme. Përkundër kësaj, përfaqësuesi i Serbisë, Milentije Popoviq, ishte mbështetës i fuqishëm i propozimit, duke refuzuar të pranonte kërkesat e shqiptarëve dhe duke mbrojtur interesat e Beogradit zyrtar. Kështu, përballë interesave të kundërta, çështja e Kosovës u bë objekt i një lufte politike dhe ushtarake, e cila ndikoi thellë në fatin e shqiptarëve në Ballkan dhe në raportet e tyre me shtetin jugosllav.⁶⁵ Procesi i aneksimit dhe shtrirjes së kontrollit jugosllav ishte një nga faktorët kryesorë që formësuan marrëdhëniet etnike dhe politike në rajon për shumë dekada më vonë.

Gjithashtu, u bënë edhe propozime për ndarjen e Kosovës në dy pjesë, ku *“qarqet drejtuese jugosllave zhvilluan përpjekje të mëdha politike për të ndarë Kosovën në Rrafshin e Dukagjinit, që do t’i bashkohej Malit të Zi, dhe pjesën tjetër të Kosovës, e cila do t’i nënshtrohej Serbisë”*.⁶⁶ Është e rëndësishme të theksohet se ndërkohë që në Beograd zhvilloheshin diskutime për të ardhmen politike të Kosovës, në të gjithë territorin e saj po kryheshin aktet e dhunës, frikësimit dhe vrasjeve ndaj shqiptarëve dhe atyre që i mbështetnin ata, nga ana e administratës ushtarake të vendosur në Kosovë (8 shkurt 1945).⁶⁷

⁶⁴ *Arkivi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme* (më tej: AMEPJ), Dosja (më tej: D.) Viti (më tej: V.) 1964, fl. 10. Relacion përmblendhës mbi vazhdimin e politikës shoviniste të Qeverisë jugosllave, për shkombëtarizimin e asimilimin e shqiptarëve të Kosovës në Maqedoni e Mal të Zi.

⁶⁵ Shefqet Dinaj, *Statusi politik-shoqëror i shqiptarëve të Kosovës në vitet 1946-1966*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2020, 85.

⁶⁶ AMEPJ, D.514/1, V.1959, fl.1. Problemi i Kosovës-studim mbi Jugosllavinë.

⁶⁷ AMEPJ, D.530/2 dhe B-VII-2-dhe, V.1960, fl.10. Relacion: Gjendja dhe problemet e popullsisë shqiptare në Jugosllavi. Tiranë, 1962. Zekeria Cana, *Ditari i Robërisë*, Vëllimi I, Prishtinë: “Rozafa”, 2000, 154-155. Azem Hajdini, *Tragjedia e Tivarit* (Memoare), Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politikë, 1998, 17-34. Uran Butka, *Masakra e Tivarit dhe përgjegjësia e shtetit shqiptar*, Tiranë: “ASD-studio”, 2011, 118-125; Fejzulla Gjabri, “Një dëshmi

Madje, Miladin Popoviqi, i cili mbante qëndrim të fortë kundër diskriminimit të shqiptarëve, u ekzekutua në Prishtinë më 12 mars 1945.⁶⁸

Ndërkohë, propozimet për ndarjen dhe riorganizimin e Kosovës ndryshonin vazhdimisht. Më shumë vëmendje mori propozimi i Eduard Kardelit, i cili në parim parashihte që Kosova të mbetej nën Serbi. Ai theksonte se “Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit, në rrethana të tjera politike, do të mund t’i bashkoheshin Shqipërisë, në mënyrë që kjo e fundit të hynte më pas në federatën jugosllave”.

Megjithatë, sipas tij, një zhvillim i tillë nuk ishte i mundur atëherë, për shkak se në Shqipëri ende nuk dominonin forcat komuniste si në Jugosllavi, si edhe për shkak të situatës së ndërlikuar politike në Ballkan.⁶⁹ Ky kundërshtim ofronte “arsye” për të ndryshuar politikën ndaj Kosovës dhe për të sakrifikuar këtë çështje në funksion të “normalizimit rajonal”. Në përputhje me këtë, udhëheqja e lartë e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë miratoi planin dhe propozimin e Kardelit, duke vendosur që “Kosova e Metohija (Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit H.A) t’i bashkëngjiten Serbisë”.⁷⁰ Ky vendim shkelte në mënyrë flagrante të drejtën e vetëvendosjes së shqiptarëve, të cilën ata e kishin shprehur në Konferencën e Bujanit,⁷¹ si dhe parimet e vetëvendosjes të Kartës së Atlantikut.⁷² Nën presionin e Degës së

nga Masakra e Tivarit”, në *E djathta shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë etnike*, Prizren: Shoqata “Trojet e Arbërit”, 2011, Nr.19, 317-320. Haxhi Ademi, *Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore: 1941–1945*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2021, 352-420.

⁶⁸ TNA, FO 371/48090, Viti 1945, Raport i ambasadorit britanik në Beograd, Ralph Skrine Stevenson, drejtuar Sekretarit të Jashtëm, Anthony Eden: Cituar sipas *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore, Arkivi Kombëtarë Britanik*, Përmbledhje dokumentesh, përzgjedhjen, përkthimin, redaktimin dhe hyrjen nga Hamit Kaba & Sabit Syla, Prishtinë, Instituti i Historisë, 2018, 518-520.

⁶⁹ Lefter Nasi, *Ripushtimi i Kosovës, Shtator 1944 - Korrik 1945*, Tiranë: Akademia e Shkençave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1994, 112.

⁷⁰ Nasi, *Ripushtimi i Kosovës*, 112; Shatri, *Kosova*, 302.

⁷¹ Për më tepër në Rezolutën e nxjerrë në Konferencën e Parë Nacionalçlirimtare për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit në Bujanë thuhej: “Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit është një krahinë e banuar në shumicë nga populli shqiptar, i cili si gjithmonë ashtu edhe sot dëshiron me u bashku me Shqipërinë”. Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (më tej: ASHAK), F. Komiteti Krahinor i LK të Kosovës, Njësia organike. Shtypi gjatë Luftës së Dytë Botërore, V.1937-1944, Nr. i kutisë 37, Lirija, nr. 12,13,14, fl.5. *Arkivi i Institutit të Historisë Tiranë*, (më tej: AIHT), F.A-V, D.15, fl.221. Koleksioni-Spasoje Gjakoviç- Konfliktet në Kosovë. Beograd, 1984. AMEPJ, D.683, V.1963, fl.15. Gjendja e popullsisë shqiptare në Kosovë.

⁷² Hamit Kaba, *Nga Lufta në paqe, Shqipëria dhe SHBA (1939-1946)*, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike Instituti i Historisë, 2020, 118.

Mbrojtjes Popullore (Odelenjeza Zashtitu Naroda – OZN-a)⁷³ Jugosllave dhe administratës ushtarake në Kosovë, më 19 shkurt u thirr mbledhja e Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë, ku u vendos që organizata partiake në Kosovë t'i bashkohej asaj të Serbisë.⁷⁴

Megjithatë, çështja e aneksimit të Kosovës nuk u mbyll vetëm me këto vendime. Për të realizuar aspiratat e PKJ-së në Kosovë, në Prishtinë, nga 19 deri më 24 mars 1945, u mbajt Konferenca e kryetarëve të këshillave popullore të rretheve dhe qyteteve të Kosovës, me pjesëmarrjen e 400 përfaqësuesve. Në këtë periudhë, ndërsa në një anë vendosej që Kosova të mbetej nën Serbi, në anën tjetër mijëra të rinj dërgoheshin në Frontin e Adriatikut. Në konferencë morën pjesë figura si Fadil Hoxha, Ali Shukria, Elhami Nimani, Predrag Ajtiq, Dushan Mugosha, Sava Dërleviq, Rifat Berisha e të tjerë. Nga 222 anëtarët e këshillave nacionalçlirimtare të rretheve, 122 ishin shqiptarë, ndërsa 100 serbë dhe malazezë; prej tyre 147 anëtarë të PKJ-së, 6 kandidatë, 6 nga Lidhja e Rinisë Komuniste të Jugosllavisë-SKOJ-it dhe 63 nga Fronti Popullor.⁷⁵

Gjatë konferencës, Xhavit Nimani u përpoq të manipulonte duke iu referuar Tititos: “*Reaksioni është i fuqishëm në Kosovë dhe Shqipëri. Prandaj, kur bashkohen, shteti i Enver Hoxhës nuk do të ketë jetëgjatësi. Ne kemi marrë për tre vjet dhe pas tyre do t'i bashkojmë përsëri viset shqiptare*”. Këto fjalë nuk u pritën mirë nga Halim Spahia kryetar i Këshillit të rrethit të Prizrenit, Hasan Kryeziu nga Suhareka, Hajdar Rustemi dhe Sheh Danjollit nga Gjakova, të cilët ngritën pyetjen: “*Pse nuk na u mundësua bashkimi me Shqipërinë, të fituar me luftën tonë?*”. Për shkak të këtyre pikëpyetjeve dhe qëndrimeve të tjera të shprehura gjatë takimit, Halim Spahia më pas u vra nga forcat serbo-jugosllave.⁷⁶

Gjatë zhvillimit të Konferencës në Prishtinë, ndër të tjera u diskutua edhe për rekrutimin e shqiptarëve për në Frontin e Adriatikut, si dhe për mungesën e simboleve kombëtare të rekrutëve. I menjëhershëm ishte reagimi i Nimanit, “*Po lyp kuq e z i[...] e këtu në sallë e kemi flamurin dy metra*”. Mirëpo, pas

⁷³ Më 14 maj 1944 me vendim të Shtabit Suprem të UNÇJ-së, u formua OZN'a (Odelenjeza Zashtitu Naroda – Dega e Mbrojtjes Popullore), e cila fillimisht ka vepruar në kuadër të seksionit të MP të KANÇJ'së. Të gjitha dokumentet e kohës flasin se OZN'a se përgjegjës i veprimtarisë së OZN'as ishte Aleksandër Rankoviqi.

⁷⁴ Lalaj, *Dosjet*, 232; Dinaj, *Statusi politik*, 85.

⁷⁵ Dinaj, *Statusi politik*, 86.

⁷⁶ Dinaj, *Statusi politik*, 89-90.

shumë diskutimeve, Elhami Nimani propozoi që të zgjidhej një delegacion mbi 29 anëtarë që do të vizitonte Titon në Beograd.⁷⁷

Në harkun kohor 27-28 mars 1945, u mbajt Konferenca e Tretë e Komitetit të PKJ-së për Kosovë. Qëllimi i kësaj konference ishte që Komiteti i PKJ-së për Kosovë të shkëpuste lidhjet me KQ të PKJ-së dhe të kalonte nën varësinë e Komitetit Krahinor të PKJ-së së Serbisë. Pra, qëllimi ishte realizimi i aneksimit të Kosovës nga ana e Serbisë.⁷⁸ Gjithashtu, në këtë konferencë ishte zgjedhur edhe Komiteti i ri i PKJ-së për Kosovë, si dhe sekretari i ri i KQ, Gjoko Pajkoviç, ish-ministër i Punëve të Brendshme në Mal të Zi.⁷⁹ Zgjedhja e tij (në fakt emërimi nga vet Tito) u bë për shkak se ish-sekretari, Milladin Popoviç tashmë ishte vrarë,⁸⁰ dhe mbante po atë post.⁸¹

Ndër vendimet më të rëndësishme të Konferencës së Tretë të Komitetit të PKJ-së për Kosovë ishte formimi i “Komitetit Nacional Shqiptar”, ku delegatët pjesëmarrës zgjodhën edhe kryesinë: Fadil Hoxha u zgjodh kryetar i Komitetit, ndërsa Xhavit Nimani sekretar. Ky komitet do të funksiononte në kuadër të FNC-së për Kosovë. Në periudhën e Administrimit Ushtarak, komiteti i sapoformuar ishte plotësisht i kontrolluar dhe shërbente si fasadë politike për legjitimimin e qëllimit që Kosova të përfshihej në kuadër të Serbisë.⁸²

Vlen të përmendet takimi i zhvilluar më 4 prill 1945, në Beograd, ndërmjet Titos dhe delegacionit shqiptar të kryesuar nga Mehmet Hoxha. Në këtë delegacion bënin pjesë edhe Siman Vasileviç dhe Dushan Mugosha, të cilët e mbikëqyrnin dhe kontrollonin delegacionin shqiptar. Në takimin me Titon, Mehmet Hoxha si kryetar i delegacionit ishte ai që do të fliste. Nën presionin e delegatëve serbë, ai braktisi qëndrimin e mirëfilltë shqiptar, dhe, gjatë leximit të referatit, deklaroi *“Për të drejtat e reformës agrare... ku kërkoi që tokat të mos u ndaheshin vetëm shqiptarëve, por të shpërndareshin për të gjithë banorët e Kosovës. Sipas Hoxhës, tokat e shqiptarëve duhej të ndaheshin edhe me kolonët dhe me këdo tjetër që ndodhej në territorin e Kosovës”*.

⁷⁷ Dinaj, *Statusi politik*, 89-90.

⁷⁸ Dinaj, *Statusi politik*, 91-92.

⁷⁹ AMEPJ, D.514/1, V.1959, fl.1. Problemi i Kosovës-studim mbi Jugosllavinë.

⁸⁰ TNA, FO 371/48090, Viti 1945. Raport i ambasadorit britanik në Beograd, Ralph Skrine Stevenson, drejtuar Sekretarit të Jashtëm, Anthony Eden: Cituar sipas Kaba & Syla, *Shqiptarët*, 518-520.

⁸¹ Dinaj, *Statusi politik*, 92.

⁸² Lalaj, *Dosjet*, 386; Dinaj, *Statusi politik*, 93.

Fjalimi i tij u kundërshtua në mënyrë të hapur nga Halim Spahia, duke i kërkuar të “*drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje, si dhe kundërshtoj ashpër kthimin e kolonëve serbë në Kosovë*”.⁸³ Në takim me Titon, delegacioni shqiptar kishte përgatitur shtatë kërkesa,⁸⁴ por të cilat nuk u plotësuan tërësisht.⁸⁵ Me gjithë kundërshtimin e tyre dhe qëndrimin që mbajti një pjesë e delegacionit shqiptar,⁸⁶ nuk arritën që ta pengonin që komunizmi të promovohet si ideologji e një sistemi shtetëror dhe shoqëror. Në këtë takim, Tito me dinakëri, ndër të tjera, promovonte këtë ide: “*Populli shqiptar në Jugosllavinë e re do të gëzojë ato të drejta që popullin e bënë, popull*”.⁸⁷ Por në fakt dallimet ndëretnike u treguan të vështira për t’u kaluar, në veçanti kur bëhej fjalë për shqiptarët, ndaj të cilëve dhuna dhe terrori shtetëror nuk kishte të ndalur.

Me mbledhjet, takimet dhe vendimet e sipërshënuara, çështja e aneksimit të Kosovës nuk përfundoi, andaj, politika shtetërore serbe dëshironte të përfitonte në kohë dhe për çështjen e aneksimit të saj në mënyrë publike dhe për herë të parë u shtrua çështja për diskutim në Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Kuvendit Antifashist Nacionalçlirimtar të Serbisë, që u mbajt në Beograd, më 7, 8 dhe 9 prill 1945. Ishte me rëndësi që në këtë mbledhje, krahas përfaqësuesve serbë, morën pjesë edhe 22 përfaqësues nga Vojvodina dhe vetëm dy përfaqësues nga Kosova, prej të cilëve njëri ishte shqiptar, ndërsa tjetri malazez. Pra, ishin Mehmet Hoxha, në cilësinë e kryetarit të Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar të Kosovës dhe Dushan Mugosha, që ishte sekretar i këtij këshilli.⁸⁸ Duhet theksuar se Mugosha, megjithëse u paraqit si delegat i Kosovës, nuk kishte mandat të dhënë nga populli shqiptar, por vepronte si i emëruar politikisht. Megjithatë, ai deklaroi se shprehte “dëshirën” e rreth

⁸³ Bashota, *Halim Spahia*, 195-196.

⁸⁴ Nga burimet e tërthorta dhe nga hipotezat del që ishin së paku tri nga shtatë kërkesat që Tito nuk mund t’i pranonte dhe ato ishin: Të respektohen të drejtat kombëtare si ajo e përdorimit të simboleve kombëtare, të njihet e drejta e vetëvendosjes dhe të burgosurit pa faj të falëshin. Dinaj, *Statusi politik*, 96-97.

⁸⁵ Shatri, *Kosova*, 306; Dinaj, *Statusi politik*, 196.

⁸⁶ Për qasjen dhe qëndrimin që kishin nëntë nga anëtarët e delegacionit shqiptar sapo u kthyen nga Beogradi dhe në vitet në vazhdim, u likuiduan. Më gjerësisht shih: Femi Pushkollli, *Mbrojta Kombëtare shqiptare e Kosovës 1878-1900*, Prishtinë: Zëri, 1991, 131-133.

⁸⁷ Dinaj, *Statusi politik*, 97.

⁸⁸ *AMEPJ*, D.909 (B/VII-2dh), V.1963, fl.2. Të dhëna për Mbledhjen e Kuvendit Antifashist Nacionalçlirimtar të Serbisë në Beograd, prill 1945; Nasi, *Ripushtimi*, 112; Keçmezi-Basha, *Kosova 1945-1990*, 56.

700 mijë shqiptarëve dhe 100 mijë malazezëve për bashkimin e Kosovës me Serbinë.⁸⁹ Pra, Mugosha ishte i pranishëm në këtë takim, me qëllim që të shprehte “*dëshirën e KNAÇ-së të Kosovës dhe të popujve të Kosovës, që ajo t'i aneksohej Serbisë*”. Megjithëse ky pjesëmarrës, vuri në dukje në fund të fjalimit të tij, se “*Ne nuk e kemi marrë këtë vendim në Kuvendin tonë, për shkak se në Kosovë ekziston pushteti ushtarak*”.⁹⁰ Në anën tjetër, kjo çështje nuk është diskutuar fare në Kosovë.⁹¹ Në Kuvendin Antifashist Nacionalçlirimtar të Serbisë, atë që Tito e mbante në heshtje, u shpreh hapur nga Aleksandër Rankoviçi. Duke iu referuar çështjes së Kosovës, ai theksoi se aneksimi i saj nga Serbia përbënte “përgjigjen më të mirë ndaj atyre që flasin për rrezikun e copëtimit të tokës serbe dhe që akuzojnë Luftën Nacionalçlirimtare se po dobësonte serbët në dobi të kroatëve dhe popujve të tjerë.”⁹²

Në forumet e sipërhënuara është bërë përpjekje që aneksimi i Kosovës të promovohet si shprehje e vullnetit të vetë popullit të Kosovës. Në fakt, qëndrimi i shqiptarëve ishte krejt i kundërt prej qëllimeve të PKJ-së, sipas së cilës, kërkesat e ligjshme të shqiptarëve në Kosovë për zgjidhjen e drejtë të problemit kombëtar, për realizimin e barazisë së plotë me popujt e tjerë të Jugosllavisë, u vlerësuan të jenë kërkesa shoviniste, reaksionare e panshqiptare.⁹³ Andaj, qëndrimi i PKJ-së binte ndesh me qëllimet e shqiptarëve, ngase trajtimi i problemit kombëtar të popullit shqiptar nuk u përgjigjej aspiratave të tyre. Madje, në shumë raporte të kohës, theksohet qartë, se “*Populli në çdo rast kërkon bashkimin me Shqipërinë*”.⁹⁴

Kështu, organizata e partisë në Kosovë, deri në mars 1945 varej drejtpërdrejt nga KQ i PKJ-së, ndërsa pas Konferencës së Tretë të Komitetit Krahinor, që i zhvilloi punimet në fund të muajit mars 1945, u vendos që Komiteti Krahinor⁹⁵

⁸⁹ AMEPJ, D. 909 (B/VII-2dh), V.1963, 2. Të dhëna për Mbledhjen e Kuvendit Antifashist Nacionalçlirimtar të Serbisë në Beograd, prill 1945.

⁹⁰ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. IV, 342.

⁹¹ Nasi, *Ripushtimi*, 101.

⁹² AMEPJ, D. 909 (B/VII-2dh), V.1963, fl. 3. Të dhëna për Mbledhjen e Kuvendit Antifashist Nacionalçlirimtar të Serbisë në Beograd, prill 1945.

⁹³ AMEPJ, D.514/1, V.1959, fl.1, Problemi i Kosovës.

⁹⁴ Nasi, *Ripushtimi*, 114.

⁹⁵ Komiteti Nacional i Shqiptarëve të Kosovës, i formuar me vendim të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, vepronte në kuadër të Frontit të Përbashkët Nacionalçlirimtar. Zbatimi i këtij vendimi iu besua Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë. Në mars të vitit 1945, në të gjitha nivelet organizative – komitete rrethesh, komunash dhe fshatrash – u themeluan komitetet e shqiptarëve. Konferenca Themeluese e KNSHK-së u mbajt në Prisht-

të kalonte nën varësinë e Komitetit Krahinor të PKJ-së për Serbinë.⁹⁶ Më pas, problemi i aneksimit të Kosovës në kuadrin e Republikës së Serbisë u diskutua dhe u vendos nga forumet drejtuese të Republikës së Serbisë dhe padyshim të Federatës Jugosllave. Kështu, akuzat ndaj shqiptarëve, të cilët, sipas serbëve, mbajtën qëndrim armiqësor ndaj Lëvizjes Nacionalçlirimtare, u shfaqën hapur në Kongresin Themelues të Partisë Komuniste të Serbisë, që u mbajt më 8-12 maj 1945. Pas Kongresit I të PKS, problemi i aneksimit të Kosovës në kuadrin e Republikës së Serbisë u shtrua në mbledhjen e Frontit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar të Kosovës, që i zhvilloi punimet më 27 dhe 28 maj 1945. Në këtë mbledhje u konstatua se “alternativa e vetme e popullit shqiptar të Kosovës ishte bashkimi me Serbinë”.⁹⁷ Por, ky ishte në kundërshtim të plotë me vullnetin e popullit shqiptar të Kosovës.

Në Kosovë, nga 8 shkurti deri më 5 korrik 1945, shqiptarët përjetuan një gjendje jashtëzakonisht të rëndë, pasi vendi ishte nën administrim ushtarak. Në fillim, pushteti i këshillave antifashiste u luftua nën justifikimin e “goditjes së reaksionarëve”, por në fakt ndaj shqiptarëve u kryen krime të rënda me përmasa të mëdha.

Gjatë kësaj periudhe ushtria jugosllave komuniste ndërmori një mobilizim të detyrueshëm masiv të shqiptarëve nga të gjitha viset etnike shqiptare, duke përfshirë Kosovën dhe pjesët shqiptare të Maqedonisë. Sipas dokumenteve dhe studiuesve, me qëllim të spastrimit etnik të Kosovës dhe të viseve shqiptare përreth saj,⁹⁸ Shtabi Suprem i Armatës Jugosllave (SHSAJ) kishte dhënë urdhër për mobilizimin e 30 deri 50 mijë shqiptarëve⁹⁹ për nevojat e

inë, më 27–28 mars 1945, ku u zgjodh Plenumi dhe një Sekretariat prej dhjetë anëtarësh. Ndër detyrat kryesore të këtij komiteti ishin: mbështetja e popullit shqiptar në shfrytëzimin e rezultateve të Luftës Nacionalçlirimtare, afirmimi i të drejtave kombëtare, çlirimi social, ngritja politike dhe kulturore-arsimore, njohja me historinë dhe kulturën kombëtare, si dhe ndihma për organet e pushtetit popullor në adresimin e problemeve shoqërore në përputhje me interesat dhe kërkesat e popullit. Sabile Keçmezi-Basha, *Kuvendi i Prizrenit dhe Vendimet e Tij (8–10 Korrik 1945)*, në *Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe lufta e Drenicës (1944–1945)* Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2016, 19.

⁹⁶ Dino, *Statusi politik*, 91-92.

⁹⁷ Nasi, *Ripushtimi i Kosovës*, 116.

⁹⁸ Muhamet Pirraku, *Ripushtimi jugosllav i Kosovës 1945*, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 1992, 121-135; Muhamet Pirraku, *Tivari 1945 Kalvari i Kosovës*, Prishtinë: Lidhja e Historianëve e Kosovës “Ali Hadri”, 2005, 29.

⁹⁹ Nga Kosova do të largohen shumica e brigadave kosovare. Rreth 15 260 sa kishte Brigada VII e Kosovës, vetëm më 19-23 janar 1945 në drejtim të Vojvodinës u dërguan rreth 19 mijë rekrutë të mobilizuar. Shih në Pirraku, *Tivari 1945 Kalvari i Kosovës*, 29.

Armatës Jugosllave (AJ) në Jugosllavi,¹⁰⁰ me qëllimin se edhe Kosova po luftonte për liri.¹⁰¹

Në periudhën e administrimit ushtarak, krahas largimit nga Kosova të brigadave kosovare, do të vendoseshim aty 40 mijë ushtarë dhe oficerë elitë, të cilët kishin për detyrë ta ndihmonin vendosjen e “pushtetit popullor”, “okupimin jugosllav të Kosovës”.¹⁰² Në bazë të të dhënave të historiografisë shqiptare, numri i shqiptarëve të vrarë në Jugosllavi në periudhën në fund të Luftës së Dytë Botërore, varion nga 47.000 deri në 52.000 persona.¹⁰³

Kështu, represioni i përgjakshëm ndaj shqiptarëve, i filluar me vendosjen e Administrimit Ushtarak më 8 shkurt 1945, u shoqërua me shtypjen e çdo shfaqjeje pakënaqësie dhe me imponimin e vendimeve për ndarjen e trevave shqiptare brenda Jugosllavisë.¹⁰⁴

Vetëm dy ditë pas heqjes së administrimit ushtarak, më 8-10 korrik 1945, u organizua i ashtuquajtura Kuvend i Këshillit Popullor të Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit, i njohur në historiografi si “Kuvendi i Prizrenit”, me peshë historike për përcaktimin e pozitës së Kosovës nën hegjemoninë jugosllave. Ky kuvend, në aspektin politik, nuk kishte karakter demokratik, pasi delegatët nuk u zgjodhën nga populli.¹⁰⁵ Në të morën pjesë 137 delegatë të radhëve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë, prej të cilëve vetëm 32 ishin shqiptarë,¹⁰⁶ të cilët vëzhgoheshin nga forca të armatosura të UDB-së (Unutrašnja Državna bezbednost - Sigurimi i Brendshëm Shtetëror).

¹⁰⁰ Pirraku, *Tivari 1945 Kalvari*, 29.

¹⁰¹ Surroi, *Fadil Hoxha*, 224.

¹⁰² Hakif Bajrami, “Dokumenti NOB-a i Socijalisticka Revolucije – Borbe na Kosova (mars-maj 1945)”, në *Vjetari*, Nr. XXIII/1987. Prishtinë: Arkivi i Kosovës, 203-367; Pirraku, *Tivari 1945*, 31.

¹⁰³ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll.IV, 343; Lalaj, *Kosova rruga e gjatë*, 33; Bashota, *Halim Spahia*, 284.

¹⁰⁴ Marenglen Verli, “Disa konsiderata për ngjarjet kulmore politiko-ushtarake në Kosovë në muajt e fundit të Luftës së Dytë Botërore”, në *Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe Lufta e Drenicës (1944-1945)*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2016, 59.

¹⁰⁵ Malcolm, *Kosova*, 399.

¹⁰⁶ Sipas disa burimeve, në Kuvend morën pjesë gjithsej 137 delegatë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë, prej të cilëve 32 shqiptarë: shih Sabile Keçmezi-Basha, *Kuvendi i Prizrenit dhe Vendimet e Tij (8–10 Korrik 1945)*, në *Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe lufta e Drenicës (1944–1945)* (Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2016), 27. Malcolm, *Kosova*, 399. Ndërsa, në burime të tjera përmendet se në kuvend morën pjesë 142 delegatë, nga të cilët 33 shqiptarë: shih Jusuf Buxhovi, *Kosova – Historia e një tragjedie (1912–1999)*, vëll. II, Prishtinë: Faik Konica, 1998, 219.

Përbërja etnike e delegatëve ishte krejtësisht e shtrembëruar në raport me realitetin demografik, pasi në atë periudhë shqiptarët përbënin shumicën absolute të popullsisë së Kosovës.¹⁰⁷ Në këtë kuvend u miratua, pa votim dhe pa nënshkrime, një rezolutë e përgatitur më parë në Beograd, sipas së cilës, Kosova aneksohej nga Serbia Federale.

Më 8 korrik 1945, kryetari i Këshillit Popullor Krahinor të Kosovës, Mehmet Hoxha, shpalli hapjen solemne të sesionit të Kuvendit, dhe, në fjalën e tij hyrëse, përshëndeti këshilltarët e pranishëm si dhe delegacionet e ardhura nga qeveritë e Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë, të cilat kishin ardhur për të dhënë mbështetje politike dhe legjitimitet formal vendimeve që pritej të merreshin. Fjalimi i tij u përkthye menjëherë në gjuhën serbe nga Boshko Çakiq,¹⁰⁸ gjë që dëshmon se organizatorët kishin menduar paraprakisht për një kontroll të plotë gjuhësor, politik dhe simbolik mbi rrjedhën e punimeve të këtij kuvendi. Pas kësaj ceremonie hapëse u procedua me zgjedhjen e kryesisë së punës, dhe, në emër të saj, Mehmet Hoxha propozoi rendin e ditës, i cili përbëhej nga njëmbëdhjetë pika,¹⁰⁹ të hartuara më parë për të orientuar drejtimin e diskutimeve në përputhje me interesat e Beogradit.

Në vijim, është e rëndësishme të theksohet se përbërja e delegatëve në Kuvendin e Prizrenit ishte e manipuluar dhe e zgjedhur me kujdes nga strukturat e OZN-së¹¹⁰, shërbimit famëkeq jugosllav të sigurisë, i cili kishte për detyrë të siguronte praninë e elementëve të bindur ndaj regjimit dhe të eliminonte çdo zë kundërshtues. Delegatët, të cilët përfaqësonin rrethe dhe qytete të ndryshme të Kosovës, nuk ishin të zgjedhur nga populli, por disa të përzgjedhur sipas kriterëve politike dhe lojalitetit ndaj pushtetit të ri

¹⁰⁷ Shatri, *Kosova*, 308; *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. IV, 342.

¹⁰⁸ *Narodni Odbor Autonome Kosovsko-Metohijske Oblasti (1943-1954)*, Osnovi materijali sa zasedanje, Prishtinë, 1955, 19.

¹⁰⁹ Rendi i ditës pika 1. Zgjedhja e komisionit verifikues; 2. Raporti i punës së Këshillit ekzekutiv krahinor; 3. Diskutimi rreth këtij raporti; 4. Referati për situatën politike; 5. Diskutim rreth këtij referati; 6. Projekt rezoluta për aneksimin e Kosovë Metohis Serbisë Federale; 7. Zgjedhja e delegatëve për Kuvendin Popullor të Serbisë; 8. Zgjedhja e delegatëve për Këshillin Antifashist të çlirimit kombëtar të Jugosllaves; 9. Zgjedhja e këshilltarëve të këshillit popullor të krahinave; 10. Zgjedhja e Këshillit ekzekutiv krahinor; 11. Zgjedhja e Gjyqit Krahinor. *Narodni Odbor Autonome Kosovsko - Metohijske Oblasti (1943-1954)*, 49.

¹¹⁰ Më 14 maj 1944 me vendim të Shtabit Suprem të UNÇJ-së, u formua OZN'a (Odelenjeza Zashtitu Naroda – Dega e Mbrojtjes Popullore), e cila fillimisht ka vepruar në kuadër të seksionit të MP të KANÇJ'së. Të gjitha dokumentet e kohës flasin se OZN'a se përgjegjës i veprimtarisë së OZN'as ishte Aleksandër Rankoviçi.

komunist jugosllav. Këta delegatë, në ditën e tretë të punimeve, nën presion të drejtpërdrejtë dhe të vëzhguar nga aparati i sigurisë, “miratuan” pa debat të vërtetë një “rezolutë” të përgatitur paraprakisht në Beograd, në të cilën kërkohej që Kosova të “bashkohej” me Republikën Popullore të Serbisë.¹¹¹

Sa i përket dimensionit kolonizues të Kuvendit të Prizrenit, në dokumentet e tij theksohet: “*Këshilli Krahinor i Kuvendit të Kosovës dhe Metohisë, njëzëri deklaroi se popullsia e kësaj krahine, ashtu si edhe popujt e tjerë të Jugosllavisë, kurrë nuk e ka pranuar ndarjen e saj nga Jugosllavia nga ana e okupatorit. Në këtë frymë, shprehet pëlqimi dhe dëshira e popullsisë që Kosova t’i bashkëngjitet Serbisë Federale si pjesë përbërëse e saj. Populli i kësaj krahine është i bindur se në qeverinë popullore të Serbisë do të gjejë mbrojtje të plotë, ndërsa nga pushteti popullor i Jugosllavisë do të përfitojë ndihmë të gjithanshme për zhvillimin politik, kombëtar, ekonomik dhe kulturor. Përfaqësuesit e krahinës në Kuvendin Popullor të Serbisë dhe në Këshillin Antifashist të Çlirimit Nacional të Jugosllavisë¹¹² (AVNOJ) do të japin kontributin e tyre për ndërtimin e Serbisë Demokratike dhe të Jugosllavisë Federale Demokratike*”.¹¹³ Gjithsesi, në këtë Kuvend u aprovua Rezoluta e cila e vendoste Kosovën si territor brenda kufijve të Jugosllavisë. Por vendimet nuk ishte as rezultat i vullnetit të lirë të popullit shqiptar e as produkt i një debati politik demokratik, por një akt i imponuar nga forca dhe rrethanat. Disa nga delegatët shqiptarë që guxuan të kundërshtonin një akt të tillë politik e juridik, më vonë u përballën me pasoja të rënda: disa prej tyre e humbën jetën, ndërsa të tjerë u dënuan me shumë vite burg, duke u shpallur armiq të regjimit.¹¹⁴

Ky bashkim i dhunshëm i Kosovës me Serbinë Federale nuk ishte thjesht një vendim formal i Kuvendit, por një akt i rëndë politik që shënonte vijimin e padrejtësive historike ndaj popullit shqiptar, i cili kishte mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë londineze.

¹¹¹ ASHAK, Fondi: Komiteti Krahinor i L. K. të Kosovës, viti 1945, kutia 23/A, dok. nr. 2352, fl. 1-2. Rezolucion i Asamblesë Krahinore të Kosovës e Metohisë.

¹¹² Antifašističko veće Narodnog Oslobođenja Jugoslavije shte organi më i lartë politik i lëvizjes nacionalçlirimtare jugosllave gjatë Luftës së Dytë Botërore, që vendosi bazat për formimin e Jugosllavisë federale pas vitit 1945.

¹¹³ *Narodni Odbor AKMO 1943–1953*, Prishtinë, 1955, 44–45. Ibrahim Berisha, *Vdekja e Kolonisë* (Prishtinë: Botime Artini, 2016). 98.

¹¹⁴ https://merbraha.com/halim-spahia-nje-jete-e-tere-ne-sherbim-te-ceshtjeskombetare/?utm_source=chatgpt.com

Në këtë mënyrë, populli shqiptar i Kosovës i cili kishte kontribuar në Luftën e Dytë Botërore me shpresën e një lirie të plotë kombëtare, u mashtrua rëndë nga premtimet boshe dhe demagogjike të udhëheqjes jugosllave,¹¹⁵ si dhe nga ajo pjesë e “elitës shqiptare” e integruar në strukturat e regjimit, që u bë pjesë e kësaj padrejtësie historike.

Në të ashtuquajturin “Kuvend të Prizrenit” u mor një nga vendimet më të rënda për fatin e Kosovës dhe të shqiptarëve. Atu u anashkaluan në mënyrë të njëanshme vendimet e mëparshme të Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit, i formuar në Konferencën e Bujanit, ku ishte shpallur qartë vullneti politik i popullit shqiptar për bashkimin me Shqipërinë.

¹¹⁵ Duke u mbështetur në vijën politike të përcaktuar në Konferencën e Pestë të PKJ-së, të mbajtur në Zagreb më 19–23 tetor 1940, Komiteti Krahinor i PKJ-së për Kosovë vendosi në nëntor të vitit 1943 të thërriste konferencën e Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovë dhe Rrafshin e Dukagjinit. Vendimet e Konferencës së 5-të kishin theksuar domosdoshmërinë e forcimit të strukturave ilegale të Partisë, përgatitjen për luftë të armatosur kundër fashizmit, krijimin e këshillave nacionalçlirimtare në të gjitha rajonet e Jugosllavisë, si dhe njohjen e së drejtës së popujve për vetëvendosje. Pikërisht këto orientime ideologjike dhe organizative u përdorën si bazë për themelimin e strukturave të LNÇ-së në Kosovë. Në këtë kuadër, Komiteti Krahinor i PKJ-së për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit organizoi një konsultë në malet e Sharrit, më 3–5 nëntor 1943, ku u morën disa vendime thelbësore: 1) ndryshimi i emërimit nga “Metohi” në “Rrafshi i Dukagjinit”; 2) formimi i Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit; 3) themelimi i Shtabit Kryesor të LNÇ-së dhe i aradheve partizane për këtë hapësirë; 4) formimi i Komitetit Krahinor të Partisë; dhe 5) krijimi i Komitetit Provincial të Partisë për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit. Në këtë takim u caktuan edhe delegatët për mbledhjen themeluese të Këshillit Nacionalçlirimtar. Nga pikëpamja ushtarake, vendimet e Sharrit e integruan LNÇ-në e Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit në të njëjtën linjë organizative me njësitë e tjera territoriale të Jugosllavisë. Ndërkohë, për të zgjeruar dhe legjitimuar luftën antifashiste në Kosovë, udhëheqja e LNÇ-së thirri Konferencën e Bujanit, e cila u mbështet drejtpërdrejt në parimet e Konferencës së 5-të të PKJ-së, sidomos në atë që i njihte popujve të drejtën për vetëvendosje. Shqiptarët e Kosovës, të vetëdijshëm se çështja e tyre kombëtare nuk mund të zgjidhej nga udhëheqja e PKJ-së apo nga PKS-hja, e panë thirrjen e kësaj konference si hapin e parë të domosdoshëm për marrjen e fatit të tyre politik në duart e veta. *AMEPJ*, D.683, V.1956, Gjendja e popullsisë shqiptare në Kosovë. Referat i mbajtur nga Meleq Babani në seminarin punonjësve të MPJ-së më 11 maj 1945, fl. 28; *AIHT*, F.A-V, D.15, fl.212. Koleksioni-Spasoje Gjakoviq-Konfliktet në Kosovë, Beograd, 1984. Sami Repishiti, Rozoluta e Bujanit, 2 janar 1944: Një analizë”, në *Studime historike*, nr.1-4, V. XLIX(XXXII), 1995. Tiranë: Akademia e Shkencave e RSH& Instituti i Historisë, 1997, 90. Mehmet Hoxha, “Formimi i Këshillit krahinor nacionalçlirimtar dhe rendisja e tij historike”, në *Përparimi*, nr.12/1959, 817-822. Muhamet Prirraku, “Vetëvendosja e Kosovës në dritën e Lëvizjes antifashiste”, *Gjurmime albanologjike, seria e shkencave historike*, nr.21/1991. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 27.

Në rezolutën e hartuar në Prizren më 1945, mes tjerash, shkruhej: “*Asambleja krahinore popullore e Kosovës e Metohisë deklaroi unanimisht se popullsia e kësaj krahine, njësoj si të gjithë popujt e Jugosllavisë, kurrë ndonjëherë nuk e ka njohur copëtimin e krahinës së vet të kryer nga okupatori, as copëtimin e Jugosllavisë, prandaj shpreh dëshirën e mbarë popullsisë së krahinës që kjo t’i bashkohet Serbisë Federale si pjesë përbërëse e saj*”.¹¹⁶

Pra, në bazë të kësaj rezolute, vendimet e “Kuvendit” të Prizrenit justifikoheshin me “parimin e vetëvendosjes”, duke e paraqitur bashkimin e Krahinës Autonome të Kosovës me Republikën e Serbisë, e përmes saj me Federatën Jugosllave, si një akt të lirë të popullsisë. Ky akt, megjithatë, zhvleftësonte plotësisht dhe anulonte vendimin e Kuvendit të Bujanit.¹¹⁷

Nëse do të merrej për bazë logjika e kësaj rezolute, atëherë do të duhej të njëjhej e drejta e shqiptarëve të cilët përbënin shumicën absolute të popullsisë së Kosovës që ta ushtronin këtë të drejtë vetëvendosjeje në çdo kohë dhe jo vetëm në korrik 1945. Me fjalë të tjera, ashtu siç sipas rezolutës ata “shprehën vullnetin” për t’iu bashkuar Serbisë në vitin 1945, në të njëjtën mënyrë duhej të kishin pasur të drejtën që më vonë të shkëputeshin prej saj.¹¹⁸

Në realitet, Kosova u aneksua në fund të Luftës së Dytë Botërore në rrethana të dhunshme dhe arbitrare. Shqiptarët, edhe pse ishin popullsi autoktone dhe përbënin shumicën absolute, u vendosën nën një presion të madh politik e ushtarak. Ata shantazhoheshin dhe akuzoheshin nga Partia Komuniste e Jugosllavisë (PKJ) për “qëndrim reaksionar”, për “bashkëpunim me pushtuesit gjermanë” apo për “dëbimin e kolonëve serbë dhe malazezë nga Kosova”. Për më tepër, nga fundi i luftës në Kosovë hynë divizione të shumta serbe dhe jugosllave, të cilat forcan më tej kontrollin mbi popullsinë shqiptare dhe e shtuan represionin ndaj saj.

Pra, në të vërtetë, Kosova iu bashkua Serbisë jo si rezultat i një vullneti të lirë të popullit, por përmes një procesi të dhunshëm politik e ushtarak. Dokumentet e kohës e vërtetojnë qartë se shqiptarët nuk u konsultuan asnjëherë, nuk u pyetën dhe nuk votuan për të qëndruar në kuadër të Republikës së Serbisë

¹¹⁶ *ASHAK*, Fondi: Komiteti Krahinor i LK të Kosovës, viti 1945, kutia 23/A, dokumenti nr. 2352, fl. 1-2. Rezolucion i Asamblesë krahinore të Kosovës e M; *AIHT*, F.A-V, D.15, fl.221. Koleksioni-Gjakoviq, Konfliktet në Kosovë, 1984.

¹¹⁷ Reginald Hibbert, *Fitorja e hidhur–Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë*, Tiranë: Lidhja e Shkrimtarëve, 1993, 22.

¹¹⁸ Lalaj, *Kosova-rruga*, 335.

dhe të Federatës Jugosllave.¹¹⁹ Ky aneksim nuk ishte një akt i menjëhershëm i korrikut 1945, por një proces i nisur më herët. Kuvendi i Prizrenit¹²⁰ në korrik 1945 shërbeu vetëm si fasadë politike për ta zyrtarizuar atë që ishte vendosur më herët. Në këtë kuvend kërkohet thjesht dhe vetëm formalisht “verdikti i popullit”, ndërsa vendimi për fatin e Kosovës kishte qenë i mbyllur dhe i vulosur qysh më parë në tavolinat e politikës jugosllave.¹²¹

Një nga vendimet më të rëndësishme, por edhe më të rënda në pasojat e tij, që u miratua në Kuvendin e Prizrenit, ishte themelimi i të ashtuquajturit “Gjyq Popullor i Krahinës”, i paraparë në pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës. Ky institucion i sapokrijuar nuk kishte për qëllim garantimin e drejtësisë dhe barazisë para ligjit, por, sipas formulimeve zyrtare të regjimit, ishte ngritur për të gjykuar dhe shkatërruar “armiqtë e pushtetit popullor, bandat kriminale balliste dhe bashkëpunëtorët e nazi-fashizmit”. Me këto etiketime, pushteti i ri komunist jugosllav përpiquej të justifikonte çdo veprim represiv ndaj kundërshtarëve politikë dhe sidomos ndaj nacionalistëve shqiptarë, të cilët konsideroheshin pengesë serioze për planet e Beogradit.

Në krye të këtij gjyqi u vendos Hivzi Sylejmani, ndërsa si anëtarë të tij u emëruan Millutin Pavliçiq, Simon Kazhiq, Ismail Gjinali, Ibrahim Muhaxhiri, Bozhidar Zuleviq dhe Pajazit Abedini.¹²² Këta persona, të cilët në dukje paraqiteshin si gjyqtarë e në realitet ishin instrumente të pushtetit komunist, të ngarkuar jo për të gjykuar mbi bazën e ligjit, por për të ekzekutuar vendime të parapërgatitura. Ata morën pjesë drejtpërdrejt në dhënien dhe zbatimin e dënimeve më të rënda: qindra shqiptarë u dënuan me pushkatim, ndërsa mijëra të tjerë u dënuan me burgime të rënda që varionin nga një deri në

¹¹⁹ AMEPJ, D.514/1, V.1959, fl.1. Problemi i Kosovës-studim mbi Jugosllavinë.

¹²⁰ Pas luftës, komunistët jugosllavë, kur ishte çështja për rishikimin e kufijve të Maqedonisë Veriore, iu referuan parimeve demokratike që dënojnë aneksimin nga pozita e forcës dhe që këto aneksime i konsideronin si përcaktim të kufijve të shteteve në kundërshtim me vullnetin e popujve. Ndonëse me të drejtën e popujve për vetëvendosje deri në shkëputje ata nënkuptonin shprehjen e lirë të vullnetit të tyre organizimin politik, ekonomik, shoqëror në kushte dhe rrethana të caktuara. Ndërsa tek shqiptarët që ishin pjesë e shtetit jugosllav, problemi i tyre kombëtar u shtrua dhe u zgjidh brenda suazave të këtij shteti. Nasi, *Ripushtimi jugosllav*, 89.

¹²¹ Sabile Basha-Keçmezi, *Shqipëria, pikë referimi për forcat nacionaliste në Kosovë, 1944-1945*, në *Studime për historinë ushtarake*, nr.8/2, Tiranë: Organ i Institutit të Studimeve të Historisë Ushtarake, 2014, 137.

¹²² Narodni Odbor Autonome Kosovsko- Metohijske Oblasti (1943-1954), 49.

njëzet e pesë vjet.¹²³ Të gjitha këto masa ndëshkuese ishin të përgatitura më herët nga punëtorët operativë të OZN-ës famëkeqe, e cila kishte krijuar një sistem terrori për të thyer çdo rezistencë shqiptare.

Shënjestër kryesore e këtyre proceseve të montuara ishin anëtarët dhe veprimtarët e Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare (LNDSH), si dhe të shumë organizatave të tjera ilegale me karakter kombëtar që kishin për qëllim mbrojtjen e interesave shqiptare dhe luftën kundër regjimit pushtues jugosllav. Në këtë mënyrë, Gjyqi Popullor nuk ishte një organ drejtësie, por një mjet politik për të shuar çdo formë organizimi kombëtar shqiptar dhe për të mbjellë frikë e nënshtrim në popull.

Vendimet e Kuvendit dhe veçanërisht ky gjyq nuk mund të konsiderohen të drejta, përkundrazi, ato ishin thellësisht të padrejta dhe me pasoja të rënda historike, sepse çështja shqiptare nuk u trajtua mbi bazën e të drejtave universale të popujve për vetëvendosje, por mbi parimin e forcës, imponimit dhe interesave të popujve dominues, siç ishin serbët, malazezët dhe maqedonasit. Në këtë kontekst ka rëndësi edhe referati mbi situatën politike që mbajti Xhavit Nimani, i cili, duke i qëndruar në linjë direktivave të Beogradit, deklaroi: “*Në mbledhjen e fundit, delegatët e Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar që kanë marrë pjesë si mysafirë në këtë mbledhje kanë shprehur dëshirën që Kosova dhe Metohia të hynë në suazën e Serbisë Federale*”.¹²⁴ Kjo deklaratë, që në thelb përfaqëson një akt nënshtrimi politik, dëshmon qartë se Kuvendi i Prizrenit ishte vetëm një fasadë për të legjitimuar vendime të parapërgatitura nga qendra jugosllave e pushtetit.

Pas këtyre vendimeve, nga 7 deri 10 gusht 1945, Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar i Serbisë aprovoi aneksimin e qarkut autonom të Kosovës në përbërje të Republikës së Serbisë. Ky akt u pasua me ligjin e 3 shtatorit 1945, pra me ligjin e Kryesisë së Kuvendit Popullor të Serbisë “Ligjin për ndarje administrative të Serbisë” dhe Ligjin “Mbi caktimin dhe ndërtimin “oblast” (qark) rajonit autonom të Kosovë-Metohisë (Dukagjinit H.A.)”, që e sanksiononte juridikisht Kosovën si njësi autonome.¹²⁵ Sipas ndarjes që bëri Serbia, rajoni i Autonom i Kosovës ishte ndarë në 15 rrethe dhe prej saj u shkëputën, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, të cilat u përfshinë në

¹²³ *Po aty*, 49-50.

¹²⁴ Nasi, *Ripushtimi*, 116-117.

¹²⁵ *AIHT*, Fondi (më tej: F.) F.A-V, Dosja (më tej: D.) 15, fl.219. Koleksioni- Spasoje Gjakoviq, *Konfliktet në Kosovë*, Beograd:1984; *Historia e Popullit Shqiptar*, IV, 342; Verli, “Disa konsiderata për ngjarjet kulmore”, 59.

përbërjen e distrikteve të tjera të Serbisë. Kosova kishte të drejtë autonome, por të gjitha të drejtat shtetërore i kishte Serbia.¹²⁶

Andaj, duke u mbështetur në këto vendime që janë marrë në mbledhjet e sipërshënuara, pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova me Kushtetutën e parë të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, të miratuar më 31 janar 1946, u definua si njësi autonome territoriale-administrative brenda Serbisë e quajtur: “Qarku Autonom i Kosovës dhe Metohisë (QAKM)”.¹²⁷

Së fundi, mund të themi se në “Kuvendin e Prizrenit”, Kosova edhe zyrtarisht u aneksua nga Serbia. Me aprovimin e Rezolutës nga Kuvendi Federativ, më 23 korrik 1945 dhe nga ai serb, më 1 shtator 1945, çështja e Kosovës do të konsiderohej çështje e mbyllur. Por, pavarësisht se gjatë LANÇ-it ishin marrë shumë vendime dhe ishin bërë shumë marrëveshje për vetëvendosjen sipas vullnetit të popullit, ato jo vetëm që nuk u respektuan, por në mënyrën më të vrazhdë u shkelën dhe u quajtën vendime armiqësore, kurse njerëzit, që i përpiluan ato, u quajtën armiq të popullit, të cilët si të tillë u ndoqën dhe u likuiduan, siç ndodhi me shumë personalitete të kohës. Aneksimi i Kosovës nga ana e Serbisë shkaktoi revoltë të populli shqiptar. Riokupimit të tretë serbo-malazez të Kosovës iu bë një rezistencë permanente, e cila vazhdoi me intensitet të ndryshëm deri në fillim të shekullit XXI.

Përfundime

Vendimet e miratuara në Prizren përmbysën aktin e Konferencës së Bujanit (1943–1944), ku shqiptarët kishin shpallur të vullnetin për bashkim me Shqipërinë. Në vend të respektimit të vullnetit kombëtar, u vendos një realitet i ri politik që copëtoi më tej hapësirën etnike shqiptare.

Studimi dëshmon se “Kuvendi i Prizrenit”, i mbajtur menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore (8-10 korrik 1945), përbënte një mekanizëm formal të dirigjuar nga qendrat politike dhe ushtarake jugosllave. Ky kuvend nuk kishte karakter të vërtetë përfaqësues dhe nuk synonte realizimin e të drejtës së vetëvendosjes së popullsisë shqiptare, por shërbeu si instrument për legjitimimin e aneksimit të Kosovës nga Serbia brenda strukturave federative të Jugosllavisë së re. Në këtë mënyrë, ai shënoi një ndër momentet më të rëndësishme dhe më dramatike të historisë politike të shqiptarëve në shekullin XX.

¹²⁶ Dinaj, *Statusi politik*, 115.

¹²⁷ Lalaj, *Kosova-rruga e gjatë*, 335.

Vendimet e marra në këtë kuvend përmbysën në mënyrë të drejtpërdrejtë Rezolutën e Konferencës së Bujanit (1943-1944), e cila kishte njohur të drejtën e shqiptarëve për bashkim me Shqipërinë. Në vend të respektimit të këtij parimi, u imponua një realitet politik që fragmentoi më tej hapësirën etnike shqiptare dhe e vendosi Kosovën nën një juridiksion të kontrolluar nga Serbia.

Karakterit i imponuar i Kuvendit u shfaq qartë në mënyrën e përzgjedhjes së delegatëve të cilët nuk u zgjodhën përmes procesit demokratik, por u emëruan nga strukturat e sigurisë jugosllave, duke eliminuar çdo mundësi të përfaqësimit autentik të popullsisë lokale. Rezolutat e kuvendit, të hartuara paraprakisht në Beograd, u shpallën si vendime kolektive, ndërkohë që përfaqësonin një agjendë të gatshme për konsolidimin e pushtetit jugosllav në Kosovë. Kjo dëshmon mungesën e çdo debati politik real dhe e shndërroi Kuvendin në një fasadë të legjitimitetit formal që maskonte procesin e aneksimit.

Një aspekt tjetër që pasoi Kuvendin ishte instaurimi i dhunës shtetërore ndaj çdo forme të kundërshtimit politik. Ata që guxuan të refuzonin vendimet e Kuvendit u përballën me burgime, ekzekutime ose shpallje si “armiç të popullit”. Me krijimin e “Gjyqit Popullor të Krahinës”, represioni u institucionalizua dhe u drejtua kundër veprimtarëve të Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare (LNDSH) dhe organizatave të tjera ilegale. Kësisoj, gjyqi nuk përfaqësonte drejtësi, por mjetin kryesor të frikësimit dhe nënshtrimit politik.

Pasojat afatgjata të këtij procesi ishin të ndjeshme dhe shumë-dimensionale. Kosova humbi çdo mundësi për të fituar status republikë brenda Federatës Jugosllave dhe u vendos nën një regjim politik, ekonomik dhe kulturor të centralizuar. Autonomia e mëvonshme që iu dha Kosovës brenda Serbisë përbënte vetëm një formë juridike të maskimit të kontrollit real serb, duke garantuar vazhdimësinë e marginalizimit dhe asimilimit të shqiptarëve.

Në një perspektivë historiografike më të gjerë, “Kuvendi i Prizrenit” shënoi konsolidimin e hegjemonisë jugosllave në Kosovë dhe zhbërjen e aspiratave kombëtare shqiptare që ishin artikuluar gjatë luftës. Ky akt politik u bë pikënisje e një periudhe të gjatë shtypjeje, dhune dhe mohimi të të drejtave kombëtare. Megjithatë, rezistenca shqiptare, në formë të ndryshme organizative e ideologjike, dëshmoi se legjitimiteti i vendimeve të imponuara nuk u pranua kurrë nga popullsia vendase dhe mbeti një element i qëndrueshëm i ndërgjegjes kombëtare gjatë gjithë periudhës së Jugosllavisë socialiste.

Bibliografi:

Burimet arkivore:

- Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK)
- Arkivi i Institutit të Historisë në Prishtinë (AIHP)
- Arkivi i Institutit të Historisë Tiranë (AIHT)
- Arkivi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (AMEPJ)
- Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)
- Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH)
- The National Archives (TNA)

Burime të botuara:

- *Narodni Odbor Autonome Kosovsko-Metohijske Oblasti* (1943–1954).
- *Narodni Odbor Autonome Kosovsko-Metohijske Oblasti (1943-1954)*, Osnovi materijali sa zasedanje, Prishtinë, 1955.
- Documents on the German Foreign Policy 1918-1945, (më tej: DGFP), Series D (1937-1945), Vol. XII, The War Years, February 1 – June 22 1941, Washington: United States Government Printing Office, 1962, Dok. 378, 595.
- Shpërngulja e shqiptarëve në Republikën e Turqisë 1922-1941, (Përmbledhje dokumentesh), Përgatitur nga Qerim Lita, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2019.
- Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore, *Arkivi Kombëtarë Britanik*, Përgatitur nga Hamit Kaba & Sabit Syla, Prishtinë, Instituti i Historisë, 2018.

Monografi & Punime shkencore:

- Abdyli, Ramiz. “Faktorët që ndikuan në ndryshimin e strukturës socialiste në fshatin e Kosovës (1918-1941).” *Kosova*, nr.15/1986. Prishtinë: Instituti i Historisë.
- Ademi, Haxhi. *Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore: 1941–1945*. Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2021.
- Arifi-Bakalli, Emine. “Çështja e Kosovës apo çështje lidhur me shqiptarët e Kosovës në parlamentin e Shqipërisë në vitet 1925-1939”, në 100 vjet parlamentarizëm shqiptar. Tiranë: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, 2020.
- Arifi-Bakalli, Emine. “Konventa jugosllavo-turke për shpërngulje e vitit 1938 në funksion të spastrimit etnik të trojeve shqiptare”, në Gjenocidi dhe aktet gjenocidale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga Kriza Lindore e këndej. ASHAK, Prishtinë, 1995.
- Bajrami, Hakif. “Dokumenti NOB-a i Socijalisticka Revolucije – Borbe na Kosova (mars–maj 1945).” *Vjetari*, Nr. XXIII/1987. Prishtinë: Arkivi i Kosovës.
- Bajrami, Hakif. Si u okupua Kosova nga Jugosllavia dhe me kërkesë të kujt, më

- 1945”, në Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe lufta e Drenicës (1944–1945). Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2016.
- Basha Keçmezi-Sabile Kuvendi i Prizrenit dhe Vendimet e Tij (8–10 Korrik 1945), në Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe lufta e Drenicës (1944–1945). Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2016.
- Basha-Keçmezi, Sabile. Kosova 1945–1990. Prishtinë: Instituti i Historisë, 2017.
- Basha-Keçmezi, Sabile. Shqipëria, pikë referimi për forcat nacionaliste në Kosovë, 1944–1945. Studime për historinë ushtarake, nr.8/2. Tiranë: ISHU, 2014.
- Bashota, Nuri. Halim Spahia, Prishtinë: “KGT”, 2012.
- Berisha, Ibrahim. Vdekja e Kolonisë, Prishtinë: Botime Artini, 2016.
- Butka, Uran. Masakra e Tivarit dhe përgjegjësia e shtetit shqiptar, Tiranë: “ASD-studio”, 2011.
- Buxhovi, Jusuf. Kosova – Historia e një tragjedie (1912–1999), vëll. II. Prishtinë: Faik Konica, 1998.
- Cana, Zekeria. Ditari i Robërisë, Vëllimi I, Prishtinë: “Rozafa”, 2000, 154-155.
- Conte, Arthur. Die Teilung der Welt – Jalta 1945. Düsseldorf: Verlag Rauch, 1965.
- Çubrilloviq, Vaso. Shpërngulja e shqiptarëve. Botuar në Zëri i Kosovës, SHBA, 1982.
- Culaj, Lush. Çështja shqiptare në Konferencën e Parisit 1919-1920, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2010.
- Dinaj, Shefqet. Statusi politik-shoqëror i shqiptarëve të Kosovës 1946–1966. Prishtinë: Instituti i Historisë, 2020.
- Drançolli, Jahja. “Rrënjët e qytetërimit ilir-shqiptar në Kosovë.” Buletini, Nr. XXV-1995. UP-Fakulteti Filozofik, 1998.
- Gjabri, Fejzulla “Një dëshmi nga Masakra e Tivarit”, në E djathta shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë etnike, Prizren: Shoqata “Trojet e Arbërit”, 2011, Nr.19.
- Gurakuqi, Romeo. Shqipëria dhe Tokat e Lirume, 1939-1946, Durrës: Botimet Jozef, 2018.
- Gurakuqi, Romeo. Shqipëria dhe Tokat e Lirume, 1939-1946. Durrës: Botimet Jozef, 2018.
- Hajdini, Azem Tragjedia e Tivarit (Memoare), Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politikë, 1998.
- Hibbert, Reginald. Fitorja e hidhur – Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë. Tiranë: Lidhja e Shkrimtarëve, 1993.
- Historia e Popullit Shqiptar, Vëllimi III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë & Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007.
- Historia e Popullit Shqiptar, Vëllimi IV, Tiranë: Akademia e Shkencave e

- Shqipërisë & Instituti i Historisë, Toena, 2008.
- Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, Vëllimi I, Akademia e Studimeve Albanologjike-Instituti i Historisë, Tiranë: Botimet albanologjike, 2017.
- Hoxha, Mehmet. “Formimi i Këshillit krahinor nacionalçlirimtar dhe rendisja e tij historike”, në Përparimi, nr.12/1959.
- Imami, Petrit. Serbët dhe shqiptarët ndër shekuj, vëll. I. Beograd: Samizdat B92, 2016.
- Kaba, Hamit & Syla, Sabit. Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore – Arkivi Kombëtar Britanik. Prishtinë: Instituti i Historisë, 2018.
- Kaba, Hamit. “Kufijtë e Shqipërisë në projektet e Aleatëve të Mëdhenj gjatë Luftës së Dytë Botërore”, në Studime historike, nr.3-4/2015. Tiranë: Akademia e Shkencave e RSH & Instituti i Historisë.
- Kaba, Hamit. Nga lufta në paqe: Shqipëria dhe SHBA (1939–1946). Tiranë: ASA – Instituti i Historisë, 2020.
- Lalaj, Ana. Dosjet e Luftës. Tiranë: Toena, 2014.
- Luftiu, Skender. Çështja e shqiptarëve në Jugosllavi (1918–1939). Prishtinë: Instituti i Historisë, 2021.
- Malcolm, Noel. Kosova, një histori e shkurtër. Prishtinë: Koha, 2011.
- Micheletta, Luca. La resa dei conti. Il Kosovo, l’Italia e la dissoluzione della Jugoslavia (1939–1941). Roma: Nuova Cultura, 2008.
- Nasi, Lefter. Ripushtimi i Kosovës, Shtator 1944 - Korrik 1945, Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1994.
- Obranoviq, Milovan. Reforma Agrare dhe Kolonizimi në Kosovë (1918–1941). Prishtinë: Instituti i Historisë, 2005.
- Pirjevec, Jože. Tito dhe shokët. Tiranë: Botart, 2020.
- Pirraku, Muhamet. “Vetëvendosja e Kosovës në dritën e Lëvizjes antifashiste”, Gjurmime albanologjike, seria e shkencave historike, nr.21/1991. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Pirraku, Muhamet. Ripushtimi jugosllav i Kosovës 1945, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 1992, 121-135.
- Pirraku, Muhamet. Tivari 1945 Kalvari i Kosovës, Prishtinë: Lidhja e Historianëve e Kosovës “Ali Hadri”, 2005.
- Poincaré, Raymond. Lufta e parë dhe e dytë Ballkanike dhe Konferenca e Londrës. Shkup: Logo-A, 2005.
- Pushkolli, Femi. Mbrojta Kombëtare shqiptare e Kosovës 1878-1900, Prishtinë: Zëri, 1991.
- Puto, Arben. Shqipëria politike (1912-1939), Tiranë: “Toena”, 2009.
- Repishiti, Sami Rozoluta e Bujanit, 2 janar 1944: Një analizë”, në Studime historike, nr.1-4, V. XLIX(XXXII), 1995. Tiranë: Akademia e Shkencave e RSH& Instituti i Historisë, 1997.

- Rifati, Fitim. Kosova gjatë Luftës së Parë Botërore 1914-1918. Prishtinë: Instituti i Historisë, 2019.
- Rothschild, Joseph. Europa Lindore Qendrore midis dy luftërave botërore. Tiranë: Dituria, 2004.
- Rushiti, Liman. Ndarje territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës 1878-1941. Prishtinë: Instituti i Historisë, 2004.
- Shatri, Muhamet. “Copëtimi i trevave etnike shqiptare në Jugosllavi. Aneksimi i Kosovës nga Serbia 1945,” Kosova, nr. 27 (2005).
- Shatri, Muhamet. Kosova në Luftën e Dytë Botërore. Prishtinë: Instituti i Historisë, 1997.
- Surroi, Veton. Fadil Hoxha në veten e parë. Prishtinë: Koha, 2010.
- Syla, Sabit. “Drenica në fund të Luftës së Dytë Botërore”, në Studime për historinë ushtarake, nr.8, Tiranë: Organ i ISHU, 2014.
- Syla, Sabit. Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2012.
- Verli, Marenglen “Disa konsiderata për ngjarjet kulmore politiko-ushtarake në Kosovë në muajt e fundit të Luftës së Dytë Botërore”, në Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe Lufta e Drenicës (1944-1945), Prishtinë: Instituti i Historisë, 2016.
- Verli, Marenglen. Reforma agrare kolonizuese në Kosovë (1918–1941). Tiranë: Akademia e Shkencave, 1992.
- Vickers, Miranda. Shqiptarët – një histori moderne. Tiranë: Bota Shqiptare, 2008.

Shtypi:

- *Epoka e Re*, Prishtinë.

Citime nga interneti:

- https://merbraha.com/halim-spahia-nje-jete-e-tere-ne-sherbim-te-ceshtjeskombetare/?utm_source=chatgpt.com.

Haxhi ADEMI

The Institute of History “Ali Hadri”

Email: ademihaxhi@hotmail.com

ORCID: 0009-0003-0165-6247

KUD: 94(496.51)(797.11)“1945”(05)

SUMMARY**THE ANNEXATION OF KOSOVO BY SERBIA IN 1945:
HISTORICAL, POLITICAL, AND LEGAL CONTEXT**

The decisions adopted in Prizren overturned the act of the Bujan Conference (1943-1944), where Albanians had expressed their will for unification with Albania. Instead of respecting the national will, a new political reality was imposed that further fragmented the Albanian ethnic space. The study demonstrates that the “Assembly of Prizren,” held immediately after the end of World War II (8-10 July 1945), functioned as a formal mechanism directed by Yugoslav political and military centers. This assembly did not have a truly representative character and was not intended to realize the right to self-determination of the Albanian population. Rather, it served as an instrument to legitimize the annexation of Kosovo by Serbia within the structures of the new Yugoslav federation. In this way, it marked one of the most important and dramatic moments in the political history of the Albanians in the twentieth century.

The decisions taken at this assembly directly overturned the Resolution of the Bujan Conference (1943-1944), which had recognized the right of Albanians to unite with Albania. Instead of respecting this principle, a political reality was imposed that further fragmented the Albanian ethnic space and placed Kosovo under a jurisdiction controlled by Serbia. The imposed character of the Assembly was evident in the manner in which delegates were selected: they were not elected through a democratic process but appointed by Yugoslav security structures, eliminating any possibility of authentic representation of the local population. The assembly’s resolutions, drafted in advance in Belgrade, were proclaimed as collective decisions, while in fact they reflected a prearranged agenda aimed at consolidating Yugoslav authority in Kosovo. This demonstrates the absence of any real

political debate and turned the Assembly into a façade of formal legitimacy that masked the process of annexation.

Another consequence that followed the Assembly was the establishment of state violence against any form of political opposition. Those who dared to reject the Assembly's decisions faced imprisonment, execution, or were declared "enemies of the people." With the creation of the "People's Court of the Province," repression became institutionalized and targeted activists of the Albanian National-Democratic Movement (LNDSH) and other illegal organizations. Thus, the court did not represent justice but served as the main instrument of intimidation and political subjugation. The long-term consequences of this process were profound and multidimensional. Kosovo lost any opportunity to gain republic status within the Yugoslav Federation and was placed under a centralized political, economic, and cultural regime. The subsequent autonomy granted to Kosovo within Serbia constituted merely a legal form masking actual Serbian control, ensuring the continued marginalization and assimilation of Albanians.

From a broader historiographical perspective, the "Assembly of Prizren" marked the consolidation of Yugoslav hegemony in Kosovo and the dismantling of Albanian national aspirations articulated during the war. This political act became the starting point of a prolonged period of oppression, violence, and denial of national rights. Nevertheless, Albanian resistance - in various organizational and ideological forms - demonstrated that the legitimacy of the imposed decisions was never accepted by the local population and remained a persistent element of national consciousness throughout the period of socialist Yugoslavia.